



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. regjistri 20/2020 (JR)
Datë 17.06.2020

Vendim nr.10 (JR)
Datë 14.04.2022

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Sokol Çomo	Kryesues
Natasha Mulaj	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Ina Rama	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 14.04.2022, ditën e enjte, ora 09:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Ferdinando Buatier de Mongeot, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Fatri Islamaj, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 220, datë 10.12.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni F i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 42 dhe nenet 1, 2, 62, 63 dhe 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe jurisprudenca e kësaj gjykate, ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, neni 46 e vijues i ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar dhe Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, fillimisht në dhomë këshillimi e më pas në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim dhe në parashtrimet në seancë gjyqësore publike, i cili përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 220, datë 10.12.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin e tij në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Natasha Mulaj, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit Fatri Islamaj (në vijim “subjekti i rivlerësimit”) ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe, për shkak të këtij funksioni, bazuar në nenin 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe nenin 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, iu nënshtroa procesit të rivlerësimit *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) administroi raportet e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit, të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor, kreu hetimin administrativ për të tria kriteret, vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, dhe për secilin kriter vlerësimi, ka konkluduar si më poshtë.

2.1. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë, [...] *subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm lidhur me pasuritë dhe të drejta të tjera reale që subjekti dhe personat e lidhur me të gëzojnë.*

Personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit (bashkëshortja) nuk ka deklaruar në deklaratën “vetting” (dorëzuar më 25.01.2017) një llogari bankare të përbashkët me vëllain e saj, për të cilën Komisioni ka hetuar disa depozita ndër vite, si dhe ligjshmërinë e burimit të krijimit.

*Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi çmon se për apartamentin me sipërfaqe 100 m², ndodhur në rr. “{***}”, Tiranë, të përdorur prej tij (para dhe pas deklaratës “vetting”), nuk arriti të sigurojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj pasurie.*

2.2. Për kriterin e kontrollit të figurës, [...] *subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi. Nuk u provua që subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, të jetë i përfshirë, apo i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë, është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.*

2.3. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, [...] *subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe konsiderohet “i aftë”.*

Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “c” e ligjit nr.

84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

3. Në përfundim, Komisioni, bazuar në pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me vendimin nr. 220, datë 10.12.2019, vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Fatri Islamaj, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë.

II. Shkaqet e ankimit

4. Kundër vendimit nr. 220, datë 10.12.2019, të Komisionit, ka ushtruar ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”) subjekti i rivlerësimit Fatri Islamaj, duke kërkuar ndryshimin e këtij vendimi dhe konfirmimin e tij në detyrë.

4.1. Shkaqet ankimore me natyrë procedurale të ngritura nga subjekti i rivlerësimit, në mënyrë të përmbledhur konsistojnë në:

4.1.1. Komisioni ka arritur konkluzione në shkelje të parimeve themelore procedurale dhe të ligjshmërisë, pasi ndaj tij është zhvilluar një proces i parregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 e 179/b, pika 2 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe nenit 4, pikat 5 e 6 dhe nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nuk janë vlerësuar drejt provat e paraqitura.

4.1.2. Në procesin e rivlerësimit në Komision, janë cenuar parime themelore të procesit të rregullt ligjor, si: i) e drejta për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, e pavarur dhe e krijuar me ligj; ii) e drejta për një proces të drejtë; iii) respektimi i së drejtës për t’u dëgjuar dhe për të pasur një mbrojtje efektive; iv) barazia e armëve në proces; v) njohja paraprake e subjektit të rivlerësimit me faktet që e ngarkojnë atë me përgjegjësi eventuale disiplinore; vi) argumentimi i shkeljeve që atribuohen nëpërmjet dhënies së sqarimeve paraprake, ashtu edhe gjatë shqyrtimit të çështjes.

4.2. Shkaqet ankimore të subjektit të rivlerësimit kundërshtojnë konkluzionet e Komisionit në vendimin e ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, në mënyrë të përmbledhur, si vijojnë.

4.2.1. *Për pasurinë në emër të babait të subjektit të rivlerësimit, apartament i ndodhur në rrugën “{***}”, kompleksi “{***}”, Tiranë*

i. Komisioni ka bërë një interpretim të gabuar të nenit 3, pika 14, nenit 32, pika 4 dhe nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9049/2003”), duke i kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të një apartamenti të përdorur kundrejt qirasë, të cilin subjekti i rivlerësimit nuk e ka në pronësi, posedim apo përdorim, si dhe nuk gëzon të drejta reale mbi të.

ii. Konsiderimi i babait të subjektit, person tjetër i lidhur në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, duke e çmuar marrëdhënien të paktën si huapërdorje sipas nenit 901 e vijues të Kodit Civil, është haptazi i pabazuar në prova dhe në kundërshtim të hapur me jurisprudencën e Kolegjit.

iii. Subjekti i rivlerësimit ka pasur një marrëdhënie qiraje me babain e tij për këtë apartament, që në kuptim të nenit 4, pika 1, germa “h” e ligjit nr. 9049/2003, nuk ka pasur detyrimin ligjor të deklarojë këtë marrëdhënie, për faktin se vlera e qirasë nuk kalon shumë mbi 300.000 lekë në vit, për t’u konsideruar shpenzim i deklarueshëm.

iv. Pas depozitimit, më datë 14.02.2019, nga subjekti i rivlerësimit, të dokumentacionit mbi të ardhurat e të vëllait F. I. nga ushtrimi i aktivitetit në Zvicër, Komisioni nuk ka ngritur asnjë pretendim lidhur me vlefshmërinë e këtij dokumentacioni, pavarësisht se ka pasur rreth 11 muaj në dispozicion për të njoftuar subjektin që ky dokumentacion nuk është në formën e kërkuar nga ligji e nuk përmbush kërkesat e Komisionit për ta konsideruar bindës.

v. Komisioni nuk ka marrë në konsideratë të ardhurat që kanë shërbyer si burim financimi të qiradhënësit B. I., si të ardhurat e vëllait të tij F. I. nga kontratat e shitjes së kuotave, fakte të cilat janë zyrtarisht të provuara dhe të publikuara në institucione të administratës publike, si Qendra Kombëtare e Biznesit dhe regjistri tregtar i saj, si dhe të ardhurat nga ushtrimi i aktivitetit profesional si inxhinier, aktivitet tregtar si person fizik i regjistruar, dhe si ortak e administrator i shoqërisë tregtare {***} në Zyrih, Zvicër, para vitit 2010.

vi. Për të ardhurat e vëllait A. I., qëndrimi i Komisionit lidhur me vërtetimin e datës 22.11.2019, është i kundërligjshëm dhe tendencioz, pasi ky vërtetim përshkruan për secilin vit të ardhurat bruto dhe tatimin e mbajtur mbi pagën. Vetëm paga e z. A. I., sipas subjektit, është më shumë se dyfishi i vlerës së apartamentit të blerë në vitin 2010. Komisioni nuk merr në konsideratë të ardhurat e z. A. I., nisur nga fakti se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar këto të ardhura në deklarimin e bërë në tetor 2014 para ILDKPKI-së, si një nga burimet e të ardhurave të babait, në kuadër të regjimit të përbashkët familjar deri në shtator 2010.

vii. Lidhur me të ardhurat e vëllait F. I., Komisioni gjatë hetimit administrativ apo me rezultatet e hetimit, nuk i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit që të paraqesë prova më të sakta apo më të plota, si detyrim që Komisioni ka pasur në rast se nuk ka krijuar bindjen për këto të ardhura.

4.2.2. Për llogarinë bankare të përbashkët në monedhën lek, që bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka pasur me vëllain e saj në Intesa Sanpaolo Bank ShA, subjekti i rivlerësimit në mënyrë të përmbledhur pretendon se: i) nuk ka pasur dijeni për këtë llogari bankare; ii) gjendja e kësaj llogarie justifikohet me burime të ligjshme; iii) pas datës 10.03.2008, nuk janë kryer veprime bankare nga bashkëshortja e subjektit në këtë llogari; iv) prej bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, janë kryer vetëm 4 derdhje [*veprime bankare*], tri para martese, me gjendje të papërfillshme monetare në raport me të ardhurat e saj dhe nuk ka kryer tërheqje; v) kjo llogari e përbashkët bankare rezulton e papërdorur nga bashkëshortja rreth 9 vite para dorëzimit të deklaratës “*vetting*”; vi) mosdeklarimi i kësaj llogarie, është për shkak të harresës dhe jo i vetëdijshëm.

5. Me ankimin, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar marrjen në cilësinë e provës së këtyre akteve shkresore:

- i. vërtetimin nr. {***} prot., datë 18.03.2020, të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, për të ardhurat neto të z. F. I., për periudhën 01.02.2008 deri më 31.10.2010;
- ii. vendimin “Për regjistrim personi juridik” nr. {***} regj., datë 15.02.2006, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shoqërinë “{***}” ShPK, me ortak të vetëm F. I.;
- iii. kontratën e shitjes së kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë “{***}” ShPK nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.07.2006, me shitës F. I. dhe blerës B. B. dhe D. V., për shitjen e 49% të kapitalit themeltar, në vlerën 2.450.000 lekë;
- iv. vendimin e ortakut të vetëm nr. 1, datë 25.07.2006, të shoqërisë “{***}” ShPK, për ndryshimin e pronësisë duke e shndërruar në shoqëri me ortakëri;

- v. vendimin nr. {***}, datë 16.04.2007, të Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë tregtare “{***}” ShPK, për “Miratimin e shitjes së kuotave në masën 51% që zotëron F. I. në këtë shoqëri blerëses M. B., si dhe largimin e tij nga detyra e administratorit”;
- vi. kontratën e shitjes së kuotave të shoqërisë “{***}” ShPK nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.04.2007, me shitës F. I. dhe blerës M. B., për shitjen e 51% të kuotave të shoqërisë, në vlerën 64.000 euro;
- vii. vërtetimin dhe verifikimin e dokumentacionit nr. {***} rep., datë 19.03.2020, që lidhet me e-mail-in e datës 17.03.2020, ndërmjet F. I. dhe shtetases M. B., bashkëlidhur të cilit gjendet deklarata e thjeshtë me shkrim e kësaj shtetaseje, që konfirmon përmbushjen e detyrimeve të kontratës së nënshkruar mes tyre.

5.1. Duke sjellë në vëmendje kohën e kufizuar për të paraqitur ankimin ndaj vendimit të Komisionit, si dhe situatën e jashtëzakonshme të krijuar për shkak të pandemisë së Covid-19, që kanë bërë të pamundur që provat të cilat lidhen me burimet e të ardhurave të vëllait të tij F. I. në Zvicër, të paraqiten së bashku me ankimin, subjekti i rivlerësimit në ankim, ka kërkuar mirëkuptimin e Kolegjit për t’i paraqitur ato në një moment të dytë.

5.2. Në vijim të kësaj kërkesë, subjekti i rivlerësimit, më datë 11.07.2020, ka dërguar¹ në Kolegj, aktet shkresore të mëposhtme.

i. *Ekstrakt nga llogaria personale e F. I. nr. {***}, lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore Zürich, Zvicër, për të ardhurat e periudhës 2002 – 2007 [dokument i legalizuar, përkthyer, noterizuar].*

ii. *“Regjistri tregtar i Kantonit Zürich, Zvicër” për regjistrimin më datë 23.12.2004, dhe çregjistrimin më datë 26.06.2007, të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar “{***}”, me kapital themeltar 20,000 CHF [dokument i legalizuar, përkthyer, noterizuar].*

iii. *“Regjistri Tregtar i Kantonit Zürich, Zvicër” për regjistrimin më datë 24.09.2004, dhe çregjistrimin më datë 07.06.2006, të personit fizik “{***}” [dokument i legalizuar, përkthyer, noterizuar];*

iv. *Vërtetim mbi bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare nr. {***} prot., datë 19.06.2020, të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, për F. I. për periudhën prill 2006 – prill 2007, si administrator në subjektin “{***}” ShPK.*

5.3. Subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Kolegj parashtrime “*Shtesë ankimi*”, administruar me nr. {***} prot., datë 29.09.2021, me të cilat ka depozituar:

i. *“Raport për qëllime të veçanta për verifikimin e analizës financiare të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve”, datë 06.05.2021, të përgatitur nga audituese ligjore A. C.², në lidhje me mundësinë financiare të familjes së B. I. për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë apartament me sipërfaqe 100 m², ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë.*

ii. *Kërkesë e datës 10.05.2021, e z. F. I., drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore, Tiranë, protokolluar pranë kësaj drejtorie me nr. {***}, datë 11.05.2021, lidhur me pagesën e tatimit për të ardhurat e realizuara nga diferenca e çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes së kuotave të shoqërisë “{***}” ShPK.*

iii. *Shkresë nr. {***} prot., datë 19.07.2021, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, “Kthim përgjigje” drejtuar z. F. I..*

¹ *Kërkesë e subjektit të rivlerësimit, me lëndë “Depozitimi i provave shkresore, në mbështetje të ankimit të datës 19.03.2020, kundër vendimit nr. 220, datë 10.12.2019, të KPK-së, për të cilën është regjistruar çështja nr. 20/2020, datë 17.06.2020, në KPA” [administruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 13.07.2020].*

² *Me numër licence {***}, shoqëria audituese “{***}” ShPK.*

iv. Memorandum³ drejtuar Kolegjit nga z. J. A C., ish-drejtues i projektit të USAID-it në Shqipëri, për Forcimin e Sektorit të Drejtësisë (*JuST*) për periudhën 2010 - 2015, që i referohet aftësitë profesionale dhe drejtuese të subjektit të rivlerësimit.

III. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Procesi gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

6. Kolegji, më datë 02.03.2022, mori në shqyrtim çështjen mbi ankimin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit ndaj vendimit të Komisionit, në bazë të parashikimeve të nenit 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, dhe filloi shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi mbi bazë aktesh. Kolegji shqyrtoi fillimisht shkaqet ankimore me natyrë procedurale për të vendosur mbi formën e shqyrtimit të çështjes, si dhe për të evidentuar shkelje procedurale që do të cenonin procesin e rregullt ligjor të sanksionuar në nenin 42, pika 2 e Kushtetutës dhe nenin 6, paragrafi 1 i KEDNj-së, e që do të legjitimonin Kolegjin për një shqyrtim gjyqësor publik. Në vijim, Kolegji vlerësoi të trajtojë disa nga shkaqet ankimore me natyrë procedurale të ngritura nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me procesin e rregullt ligjor.

6.1. Lidhur me pretendimin e subjektit se: *Komisioni ka cenuar nenin 6, paragrafi 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për një proces të rregullt ligjor, për sa i përket formimit të trupit gjykues, pa garancitë e nevojshme për pavarësi dhe paanshmëri, duke iu referuar jurisprudencës⁴ së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GjEDNj], ku sipas subjektit, gjykata ka caktuar nevojën për përfaqësim substancial, ku të paktën gjysma e anëtarëve të trupit gjykues duhet të jenë gjyqtarë me profesion, trupi gjykues:*

6.1.a Me konsideratë qëndrimin e mbajtur tashmë nga Kolegji në jurisprudencën e tij, thekson se përputhshmëria e veprimtarisë së institucioneve që kryejnë procesin e rivlerësimit me parimet e procesit të rregullt ligjor sipas nenit 6, paragrafi 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut [KEDNj], në drejtim të garantimit të pavarësisë dhe paansisë, i është nënshtruar analizës së kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, certifikuar fillimisht nga Komisioni i Venecias, më pas ka kaluar filtrin e testit të kushtetutshmërisë nga Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017 [paragrafët 38 dhe 67⁵] dhe së fundmi është konfirmuar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GjEDNj] në vendimin që i përket çështjes *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*⁶. Në këtë të fundit, GjEDNj-ja nuk konstatoi shkelje të nenit 6, paragrafi 1 i KEDNj-së, lidhur me mënyrën e krijimit dhe funksionimit të Komisionit dhe Kolegjit. Sa i përket vlerësimit mbi pavarësinë dhe paanshmërinë e organeve të rivlerësimit, në paragrafët 280 deri 317 të këtij vendimi, GjEDNj-ja ka konstatuar se këto organe janë të pavarura dhe të paanshme, prandaj nuk ka pasur shkelje të nenit 6/1 të Konventës në këtë drejtim.

6.1.b Trupi gjykues vlerëson të sjellë në vëmendje faktin se, për shkak të specifikës së procesit të rivlerësimit, referimi në jurisprudencën e GjEDNj-së, tashmë orientohet nga vendimi i kësaj gjykate në çështjen *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, që ka të bëjë pikërisht me bindjen dhe vlerësimin e saj mbi institucionet e procesit të rivlerësimit në Shqipëri, në drejtim të garantimit të një procesi të rregullt ligjor. Konkretisht, në paragrafët 299 dhe 300 të këtij vendimi, GjEDNj-ja ka theksuar se: 299. *Për sa i përket mospërfaqësimit të gjyqtarëve në*

³ Ky memorandum është përcjellë në adresën elektronike të Kolegjit dhe personalisht nga z. C. [regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 09.12.2021].

⁴ Referuar jurisprudencës së GjEDNj-së në çështjet *Oleksandr Volkov kundër Ukrainës*, paragrafi 109; *Ramos Nunes de Carvalho e Sa kundër Portugalisë*, paragrafi 75; *Leuven and De Meyere kundër Belgjikës*, paragrafi 58.

⁵ http://www.gjk.gov.al/web/Vendime_perfundimtare_100_1.php.

⁶ <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22:%7B%22001-208053%22%7D%7D>.

detyrë në KPK, gjykata në fakt ka theksuar nevojën për përfaqësim thelbësor të gjyqtarëve brenda organit përkatës disiplinor (shih Oleksandr Volkov, cituar më lart, paragrafi 109). Kjo nevojë është edhe më e rëndësishme në procedurat e zakonshme disiplinore kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve. Sidoqoftë, gjykata duhet të marrë parasysh natyrën e posaçme të procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri. Ky proces mori jetë në përgjigje të nevojës urgjente, siç vlerësohet nga legjislatura vendase, për të luftuar nivelin e lartë të korrupsionit që kishte pushtuar sistemin e drejtësisë. Ky proces përbëhet nga rivlerësimi i tri kriterëve dhe ka për qëllim rivlerësimin e të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë. Dhe është pikërisht kjo arsyeja që procesi i rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri, është sui generis dhe duhet të dallohet nga çdo proces i zakonshëm disiplinor ndaj gjyqtarëve apo prokurorëve.

300. Sipas këndvështrimit të gjykatës, fakti që anëtarët e KPK-së nuk vinin nga radhët e gjyqtarëve profesionistë në detyrë, ishte në përputhje me frymën dhe qëllimin e procesit të rivlerësimit, domethënë për të shmangur çdo konflikt individual interesi dhe për të siguruar besimin e publikut në këtë proces [...]. Për sa arsyetuar më sipër, e bëjnë pretendimin e subjektit të rivlerësimit të pabazuar.

6.2. Subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet ankimit, i kërkon Kolegjit, si pjesë e Gjykatës Kushtetuese, bazuar në nenin 131, pika “e” e Kushtetutës, të verifikojë nëse anëtarët e trupës gjyqësore që kanë marrë vendimin objekt ankimi i plotësojnë apo jo kushtet formale të zgjedhshmërisë në atë detyrë, sipas nenit 6 të KEDNJ-së, pasi nëse nuk plotësohen këto kritere atëherë është cenuar e drejta për t’u gjykuar nga një gjykatë e krijuar me ligj.

6.2.a Sa i përket këtij pretendimi, trupi gjyqësor vlerëson se kompetencat për verifikimin e plotësimin të kriterëve përzgjedhëse të anëtarëve të organeve të rivlerësimit të parashikuara nga neni C, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe neni 6 i ligjit nr. 84/2016, dispozitat kushtetuese dhe ato ligjore ua kanë ngarkuar institucioneve të tjera, konkretisht Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Avokatit të Popullit, Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit dhe Kuvendit të Shqipërisë [shih nenin C, pikat 6 deri 12 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 7 deri 11 të ligjit nr. 84/2016]. Sa më sipër, referuar dispozitave kushtetuese dhe ligjore, kërkesa e subjektit nuk përfshihet në juridiksionin dhe kompetencat e Kolegjit.

6.3. Sipas subjektit të rivlerësimit në ankim, anëtarët e Komisionit që kanë marrë vendimin janë emëruar nga Kuvendi i Shqipërisë në një proces të mirëfilltë politik, duke caktuar në këtë detyrë persona të njohur për lidhjet e ngushta me strukturat politike dhe drejtuesit politikë, që kanë pasur influencë dhe kompetencë të propozojnë dhe emrat e tyre në Kuvend. Nuk është marrë asnjë masë për të reduktuar influencën politike në emërimin e anëtarëve të Komisionit, kështu që nuk ka asnjë garanci për mbrojtjen e parimit të pavarësisë dhe paanshmërisë në këtë proces.

6.3.a Ky pretendim i subjektit, në vlerësim të trupit gjyqësor, gjithashtu gjen përgjigje ezauruese në vendimin e GjEDNJ-së në çështjen *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, e cila në paragrafët 295 dhe 296, shprehet se: 295 [...] gjykata thekson se, megjithëse parimi i ndarjes së pushteteve midis organeve politike të qeverisë dhe gjyqësorit ka pësuar rritje në praktikën e saj gjyqësore, përzgjedhja ose emërimi i gjyqtarëve nga pushteti ekzekutiv ose legjislativ është i lejueshëm sipas Konventës, me kusht që, pasi të përzgjidhen ose emërohen, ata të jenë të lirë nga ndikimi ose presioni dhe të ushtrojnë veprimtarinë e tyre gjyqësore me pavarësi të plotë (shih *Sacilor-Lormines k. Francës*, nr. 65411/01, paragrafi 67, *GJEDNJ 2006 XIII*; *Flux k. Moldavisë* (nr. 2), nr. 31001/03, paragrafi 27, 3 korrik 2007; *Thiam kundër Francës*, nr. 80018/12, paragrafi 80, 18 tetor 2018; dhe *Guðmundur Andri Ástráðsson*, cituar më lart, paragrafi 207).

296. Edhe pse në përgjithësi gjykata nuk ka asnjë arsye të vërë në pikëpyetje mënyrën në të cilën u emëruan anëtarët e KPK-së, përsëri i mbetet asaj të vlerësojë nëse, në çështjen në fjalë, KPK kishte “shfaqjen/dukjen e pavarësisë” që kërkohet nga praktika gjyqësore e Gjykatës në lidhje me masat mbrojtëse kundër presionit të jashtëm. Kërkuesja nuk arriti të provojë se anëtarët e KPK-së që shqyrtuan çështjen e saj, kishin marrë ndonjë udhëzim ose kishin qenë nën presion nga pushteti ekzekutiv. Nga dokumentacioni i administruar në dosjen e çështjes, nuk rezulton të ketë ndonjë provë të një udhëzimi të tillë ose presioni që i është ushtruar trupit gjykues nga pushteti ekzekutiv. Për shkak se përpara se KPK-ja të jepte njoftimin mbi dispozitat përkatëse për çështjen e saj, Kryeministri i vendit dha një deklaratë të përgjithshme në lidhje me ecurinë e procesit të rivlerësimit në përgjithësi, pa ndonjë lidhje specifike apo të përmendte çështjen e saj, nuk mund të merret si udhëzim ose presion i ushtruar nga ekzekutivi mbi organet e rivlerësimit (shih paragrafët 22 dhe 264 më lart). Deklarata e Kryeministrit përmbante vërejtje të përgjithshme në lidhje me zhvillimet në vazhdim të procesit të rivlerësimit dhe nuk i adresojë ndonjë çështje apo individ në mënyrë specifike.

6.3.b Nga analizimi i akteve në fashikullin gjyqësor nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë ngritur ndonjë pretendim as më datë 23.11.2018, kur iu njoftua përbërja e trupit gjykues të Komisionit, të shortuar për të zhvilluar procesin e rivlerësimit ndaj tij, dhe as gjatë seancës dëgjimore të datës 03.12.2019, kur kryesuesi i trupit gjykues iu drejtua për kërkesa paraprake. Ngritja e këtij pretendimi vetëm pas marrjes së vendimit përfundimtar nga Komisioni, si dhe në kushtet kur nga aktet e dosjes nuk rezulton që trupi gjykues i Komisionit të ketë manifestuar ndonjë qëndrim në këtë drejtim gjatë procesit të rivlerësimit, në vlerësim të trupit gjykues, e bën pretendimin e subjektit të rivlerësimit të papabuar.

6.4. Subjekti i rivlerësimit pretendon se: *Komisioni ka pasur kompetenca të dubluara, si strukturë hetimi që ngre pretendimet ose akuzat dhe më pas e njëjta trupë vepron dhe si gjykatë vendimmarrëse në shkëlqje flagrante të parimit të paanshmërisë, pavarësisë, si dhe parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve në një demokraci funksionale. E njëjta trupë gjyqësore e Komisionit dhe heton faktet, edhe jep vendim në lidhje me gjetjet e bëra nga ajo vetë, pra është organ me natyrë të dyfishtë, edhe “organ akuzator” dhe “gjykatë”.* Në lidhje me këtë pretendim:

6.4.a. Kolegji ka një qëndrim të konsoliduar tashmë në jurisprudencën e tij, se kompetenca e Komisionit për të kryer hetimin dhe për të dhënë vendimin është në përputhje me natyrën e procesit të rivlerësimit, si një proces administrativ i nisur kryesisht, në përputhje me kompetencën që i njeh Kushtetuta dhe kreu VII, “Procedura e rivlerësimit”, i ligjit nr. 84/2016, në të cilin detajohen kompetencat hetimore dhe vendimmarrëse të Komisionit.

6.4.b. Gjithashtu, GjEDNj-ja në çështjen *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, në paragrafët 307 dhe 308, shprehet se: *307. Në momentin që KPK-ja mori vendimin, në përfundim të procesit, ai vlerësoi nëse provat e marra, përfshirë argumentet dhe dokumentet e parashtruara nga kërkuesja si përgjigje, mjaftonin për ta konfirmuar atë në postin e saj ose për të vendosur një sanksion disiplinor në përputhje me ligjin nr. 84/2016 [...]. Konstatimet paraprake të bazuara në informacionin e disponueshëm, jo në përfitim të mbrojtjes së kërkueses, nuk mund të konsiderohet se sjellin në vetvete ndonjë paragjykim për rezultatin përfundimtar që do të merret pas parashtrimeve të argumenteve të kërkueses në seancë publike. Ajo që është e rëndësishme është që vendimi përfundimtar të merret në bazë të të gjithë elementeve në dispozicion, përfshirë provat e paraqitura dhe argumentet e parashtruara në seancë [...]. 308. Prandaj, nuk ka asnjë ngatërresë mes detyrimit ligjor të KPK-së për të hapur hetimin, në të cilin nuk u bënë akuza ose konstatime të shkëlqeve disiplinore të kërkueses, dhe detyrës së tij për të marrë një vendim në lidhje me përgjegjësinë disiplinore të kërkueses. Një rregullim i tillë procedural nuk është i pazakontë në proceset disiplinore apo procese të tjera administrative në sistemet ligjore evropiane. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, vetëm fakti i*

thjeshtë që KPK-ja konstatoi gjetje paraprake në çështjen e kërkueses nuk është i mjaftueshëm për të nxitur ndonjë frikë të justifikuar objektivisht në lidhje me paanësinë e KPK-së.

Sa më sipër, pretendimi i subjektit për cenim të parimit të paanshmërisë, pavarësisë, si dhe parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve në një demokraci funksionale, për rrjedhojë, të procesit të rregullt ligjor, për shkak se e njëjta trupë gjykuese heton dhe vendos, është i pabazuar.

6.5. Subjekti i rivlerësimit pretendon se afati kohor prej vetëm 12 ditësh, i vënë në dispozicion, pasi i ka kaluar barra e provës për tetë çështje, me rezultatet e hetimit administrativ të përbërë nga 42 faqe, ka qenë i pamjaftueshëm duke pasur parasysh që Komisioni kishte rreth 11 muaj që bënte hetim administrativ.

6.5.a Nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore, trupi gjykues konstaton se, më datë 08.11.2019, nëpërmjet adresës elektronike, Komisioni i përcjell subjektit të rivlerësimit rezultatet e hetimit administrativ të zhvilluar kryesisht për të tria kriteret e rivlerësimit, duke e ftuar të njihet me dosjen, të marrë kopje të saj, të kërkojë thirrjen e dëshmitarëve apo marrjen e çdo prove mbështetëse, duke i njoftuar afatin 20.11.2019, për paraqitjen e shpjegimeve në lidhje me këto rezultate hetimi.

Më datë 12.11.2019, subjekti i rivlerësimit i njofton Komisionit se: *duke marrë parasysh që kërkohet të paraqitet një dokumentacion voluminoz [...] që lidhet me burimet financiare të shtetasve E. e P. K., dhe A. L. në formë të legalizuar, jam duke marrë masa që ky dokumentacion origjinal i prodhuar në shtetin grek, Athinë, të dërgohet për legalizim në Athinë dhe më pas ta paraqes për përkthim dhe noterizim në Shqipëri, me qëllim që t'ia vë në dispozicion Komisionit. [...] Nëse nuk arrij ta kem gati këtë dokumentacion deri në dt. 20.11.2019, do t'ju lutem me një e-mail të dytë të më jepet një kohë shtesë në dispozicion për ta paraqitur.*

Më datë 20.11.2019, dërgohen nga subjekti i rivlerësimit, shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ në Komision me nr. {***} prot., datë 20.11.2019, dhe me e-mail-in e datës 21.11.2019, është dërguar në format elektronik edhe tabela e analizës financiare të korrigjuar, sipas subjektit të rivlerësimit.

6.5.b. Në lidhje me kohën e vënë në dispozicion nga Komisioni, si me pyetësorët, ashtu dhe me rezultatet e hetimit administrativ, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka respektuar kërkesën e Komisionit duke u përgjigjur brenda afatit në dispozicion. Në lidhje me shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, trupi gjykues konstaton se një pjesë e konsiderueshme e kërkesave të Komisionit në lidhje me kriterin e rivlerësimit të pasurisë, ishin trajtuar më herët dhe gjatë pyetësorëve. Po kështu, nuk rezulton që subjekti të ketë depozituar ndonjë kërkesë për shtyrje afati, që të jetë refuzuar nga Komisioni, për më tepër kur në kuadër të këtij procesi, subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të depozitojë prova edhe gjatë seancës dëgjimore.

6.5.c. Nga analizimi i procesit të rivlerësimit në Komision, trupi gjykues konstaton se janë respektuar të drejtat e subjektit të rivlerësimit, për të paraqitur shpjegimet e veta nëpërmjet përgjigjeve të datave 25.01.2019, 14.02.2019, 27.05.2019 dhe 15.10.2019, të pyetësorëve të Komisionit, si dhe parashtrimet e datës 20.11.2019 mbi rezultatet e hetimit. Gjithashtu subjektit të rivlerësimit i janë vënë në dispozicion aktet e dosjes, konfirmuar prej tij më datë 09.11.2019, nëpërmjet deklaratës, si dhe është dëgjuar mbi këto rezultate gjatë seancës dëgjimore të datës 03.12.2019.

7. Në vijim të shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi mbi bazë aktesh, Kolegji, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit të rivlerësimit për marrjen në cilësinë e provave të reja, të akteve shkresore që subjekti i rivlerësimit ka paraqitur nëpërmjet ankimit, u ndal në vlerësimin e faktit nëse aktet shkresore të përcjella me ankimin kënaqnin kërkesat e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012

“Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, (në vijim “ligji nr. 49/2012, i ndryshuar”), se *në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohej prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose t’i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj.* Për të konkluduar lidhur me vijimin e shqyrtimit të çështjes, trupi gjykues analizoi shkaqet e ankimit të ngritur nga subjekti, nga ku konstaton:

7.1. Subjekti në ankim ngre pretendimin se Komisioni, që pas vënies në dispozicion më datë 14.02.2019, të dokumentacionit mbi të ardhurat e z. F. I., i cili ka qenë dhe kontribuesi kryesor në ndihmën e dhënë babait për të blerë apartamentin, nuk ka ngritur asnjë pretendim lidhur me vlefshmërinë e këtij dokumentacioni dhe me faktin se nuk është paraqitur në formën e kërkuar nga ligji, pavarësisht se ka pasur rreth 11 muaj në dispozicion për të vënë në dijeni subjektin e rivlerësimit që ky dokumentacion nuk i përmbush kërkesat e Komisionit për ta konsideruar bindës. Subjekti i rivlerësimit në ankim ka kërkuar mirëkuptimin e Kolegjit për të rezervuar të drejtën për të depozituar provat në formën e kërkuar nga ligji, të legalizuara dhe të përkthyer, që provojnë të ardhurat e z. F. I., i cili ka ushtruar aktivitetin profesional si inxhinier dhe aktivitet tregtar si person fizik i regjistruar, dhe si ortak e administrator i shoqërisë tregtare {***}, në Zürich, Zvicër, të cilat, për shkak të situatës së krijuar nga pandemia nuk ka mundur t’i paraqesë me ankimin, por që më datë 13.07.2020, janë depozituar në Kolegjin sipas formës së kërkuar nga ligji.

7.2. Në analizë të këtij shkakut ankimor, trupi gjykues konstaton se me përgjigjet e datës 14.02.2019, të pyetësorit të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka depozituar një kopje të dokumentit *ekstrakt nga llogaria personale nr. {***}* e z. F. I., të lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore në Zürich, Zvicër, në gjuhën gjermane, sipas të cilit rezultojnë se shtetasi F. I. ka përfituar të ardhura në shumën 249.847 CHF në Zvicër për periudhën 2002 – 2007. Në pyetësorin e radhës, atë të datës 23.05.2019, Komisioni nuk ngre pretendime lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, në pyetësorin e datës 07.10.2019, Komisioni i kërkon subjektit të rivlerësimit të deklarojë burimin e krijimit të dy apartamenteve të blerë nga babai, në kompleksin “{***}”, rr. “{***}”, ndërsa në rezultatet e hetimit administrativ të datës 08.11.2019, Komisioni i kërkon të depozitohet dokumentacioni i justifikues ligjor për të ardhurat që kanë shërbyer për blerjen e pasurisë apartament banimi, me sipërfaqe 100 m², ndodhur në rr. “{***}”, Tiranë, pa specifikuar formën e duhur ligjore të depozitimit të tyre, siç ka vepruar për pasurinë e llojit autoveturë, tip Volvo, ku po në këto rezultate hetimi specifikon: *Shpjegoni bindshëm burimin e krijimit të kësaj pasurie nga motra e bashkëshortes suaj, duke depozituar dokumentacioni i justifikues ligjor për të ardhurat e krijuara në shtetin grek, në formën e kërkuar nga ligji (të përkthyer në gjuhën shqipe, të legalizuara dhe të noterizuara).* Me shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, rezultojnë që subjekti i rivlerësimit të ketë depozituar dokumentacionin mbi të ardhurat e krijuara në shtetin grek për shtetasit P. K., A. dhe E. L. sipas kërkesës së Komisionit.

7.3. Nga analizimi i akteve, rezultojnë se Komisioni që pas datës 14.02.2019, nuk i ka kërkuar subjektit depozitimin e akteve për të ardhurat e vëllait F. I. nga punësimi dhe aktiviteti tregtar i ushtruar në Zvicër, të legalizuara, përkthyer, noterizuara, në asnjë nga fazat e mëvonshme të hetimit, as në pyetësorët vijues, rezultatet e hetimit apo gjatë seancës dëgjimore, duke i lënë të kuptojë subjektit të rivlerësimit se e ka konsideruar të ezauruar dokumentacionin e vënë në dispozicion për këto të ardhura. Në kuptim të nenit 266 të Kodit të Procedurës Civile⁷, shkresa në gjuhë të huaj paraqitet në formën e kërkuar nga ky nen, qëndrim i mbajtur tashmë nga

⁷ Neni 266 i Kodit të Procedurës Civile, parashikon: “Kur shkresa është në gjuhë të huaj, ajo paraqitet bashkë me përkthimin e saj në gjuhën shqipe, legalizuar nga ambasada apo konsullata përkatëse ose nga organi tjetër kompetent. Kur gjykata nuk mund ta kontrollojë vetë saktësinë e përkthimit, emëron përkthyes”.

Kolegji në jurisprudencën⁸ e tij. Ndërkohë që rasti objekti shqyrtimi nuk ndodhet në të njëjtën situatë me vendimet në poshtëshënimin nr. 8, për arsye se: i) subjektit të rivlerësimit nuk i është bërë me dije nga Komisioni, me rezultatet e hetimit, mungesa e burimeve të ligjshme financiare për krijimin e apartamentit në përdorim nga ana e tij, pasi nuk rezulton të jetë kryer një analizë financiare për këtë pasuri; ii) Komisioni, ashtu sikundër ka kërkuar dokumentacion në formën e duhur ligjore për pasurinë e llojit autoveturë, tip Volvo, duhet t'i kishte kërkuar të njëjtin format dhe për dokumentacionin justifikues të të ardhurave të vëllait F. I. nga punësimi në Zvicër, dokument i cili u paraqit në formën e duhur ligjore në Kolegj. Për arsyet e cituara më sipër, si dhe për faktin që nga kontakti *prima facie* i këtij dokumenti⁹, vihen re të ardhura në masë të konsiderueshme, të cilat ndikojnë potencialisht rezultatin financiar, arsyetuar në vijim në këtë vendim, trupi gjykues nuk konsideron të drejtë qëndrimin e mbajtur nga Komisioni që, ndonëse nuk i kërkon këto akte në formën e duhur ligjore dhe nuk i jep mundësinë subjektit të rivlerësimit t'i sjellë ato, e ngarkon atë me përgjegjësi në vendimmarrje pikërisht për mungesën e formës së akteve, duke mos njohur si të provuar informacionin që rezulton nga përmbajtja e tyre.

7.4. Lidhur me këto të ardhura Komisioni në vendim, shprehet se: *nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur, rezulton se provat e depozituara nuk janë në formën e kërkuar nga legjislacioni shqiptar në fuqi, si dhe nuk evidentohen në mënyrë të qartë të ardhurat neto të përfituara dhe as tatimet e paguara mbi këto të ardhura nga z. F. I. në Zvicër.*

7.5. Në kushtet kur këto të ardhura zënë peshë specifike ndaj totalit të të ardhurave të anëtarëve të familjes "I." në masën rreth 40%, duke pasur efekt domethënës në aftësinë paguese të babait të subjektit në cilësinë e kryefamiljarit, për blerjen e apartamentit të përdorur nga subjekti i rivlerësimit për periudhën janar 2011 deri në nëntor 2017, si dhe në kushtet kur burimi i ligjshëm i krijimit të kësaj pasurie të paluajtshme, ka qenë arsyeja kryesore për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit, në mungesë të një analize financiare për të vlerësuar mjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme të familjes, trupi gjykues, me vendim të ndërmjetëm, bazuar në nenin 51, pika 1, germa "a" e ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, vendosi shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike me praninë e subjektit të rivlerësimit, pasi çmoi se debati gjyqësor ishte i nevojshëm për konstatimin e gjendjes faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë, duke u marrë prova të reja.

8. Në seancën gjyqësore publike të datës 17.03.2022, trupi gjykues, me vendim të ndërmjetëm, vendosi të marrë në cilësinë e provës aktet shkresore sipas listës që depozitoi subjekti i rivlerësimit në këtë seancë, duke i bërë ato pjesë të fashikullit të gjykimit të kësaj çështjeje, së bashku me aktet e përcjella në Kolegj në fashikullin e Komisionit. Këto akte konsistojnë në ato të cituara në paragrafin 5, pikat "i", "iii", "vi" dhe "vii", paragrafin 5.2 dhe paragrafin 5.3, pikat "i", "ii", "iii" të këtij vendimi.
9. Nga vëzhguesi ndërkombëtar i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, bazuar në nenin B, pika 3, germa "b" e Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 49, pika 11 e ligjit nr. 84/2016, u paraqit në Kolegj, *Opinion*¹⁰ nr. {***} prot., datë 23.03.2022, sipas të cilit është i pakontestuar fakti që subjekti i rivlerësimit në momentin e dorëzimit të deklaratës së pasurisë *vetting*, si dhe gjatë 6 viteve të mëparshme, ka gëzuar përdorimin e një apartamenti të peregjistruar formalisht në emër të tij, i ndodhur në rr. "{***}", Tiranë. Me referencë në parashikimet e nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës, ekziston parimi i barazimit të pasurive që zotërohen formalisht

⁸ *Shih vendimin nr. 13/2019 (paragrafi 62 dhe vendimin nr. 25/2019, paragrafi 25.2) të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.*

⁹ *Ekstrakt nga llogaria personale e F. I. nr. {***}, lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore Zürich, Zvicër, për të ardhurat e periudhës 2002 – 2007.*

¹⁰ *Administruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 23.03.2022.*

prej subjekteve të rivlerësimit dhe pasurive që janë thjesht në përdorim të tyre, edhe pse të regjistruara formalisht në emër të dikujt tjetër. Sipas *Opinionit* të vëzhguesit ndërkombëtar, këto dy situata duhet të verifikohen në të njëjtën mënyrë nga organet e rivlerësimit dhe, në të dyja këto raste, subjekti i rivlerësimit ka detyrimin të deklarojë pasuritë saktë dhe plotësisht, si dhe të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të tyre. Ky barazim në vlerësim të vëzhguesit ndërkombëtar është veçanërisht i rëndësishëm për efektivitetin e procesit të rivlerësimit, sepse përdorimi informal i pasurive do të ishte *kalë troje* lehtësisht për t'iu shmangur verifikimit të duhur. Përrjashtim të arsyeshëm nga kjo disiplinë, përbëjnë rastet ku marrëdhënia e subjektit të rivlerësimit me pasurinë është me kohëzgjatje të shkurtër dhe rastësore, saqë mund të përkufizohet si thjesht mikpritje, që qartësisht nuk gjen zbatim në rastin e subjektit të rivlerësimit Fatri Islamaj.

Kur pasuria i jepet subjektit të rivlerësimit në përdorim pa kundërshtim, dhënësi i sendit ka cilësinë e huadhënësit, sipas nenit 901 të Kodit Civil që disiplinon kontratën e përdorimit (e lidhur thjesht me dorëzimin e sendit). Thjesht cilësia e huadhënësit, shihet si aktivizues i mekanizmit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, në kuadrin e hetimit më të gjerë mbi pasuritë, sipas nenit 3, pika 11 e këtij ligji. Do të ishte e gabuar, sipas vlerësimit të vëzhguesit ndërkombëtar, të supozohet se parakushti i domosdoshëm për të pasur cilësinë e "*personit tjetër të lidhur*" dhe rrjedhimisht për të nisur hetimin e ligjshmërisë së burimeve të sendit të dhënë hua, është ekzistenca e dyshimit se subjekti i rivlerësimit është në të vërtetë pronar i sendit/pasurisë. Neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 nuk evokon dyshimin e fshehjes si një parakusht për zbatimin e tij, për më tepër do të përbente inversion logjik, në kuptimin se është pikërisht mungesa e burimeve të ligjshme, e konstatuar nga zbatimi i nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, që shërben si tregues i zotërimit potencialisht fiktiv të një pasurie që vlerësohet bashkë me faktet e konstatuara prej hetimit.

Nëpërmjet këtij *Opinionit*, vëzhguesi ndërkombëtar shprehet se Kolegji duhet eventualisht të cilësojë elementet faktike të konstatuara prej hetimit, duke pasur tagrin dhe detyrimin të vlerësojë në autonomi të plotë të gjitha faktet që lidhen me pasurinë e sjellë në vëmendjen e tij nga subjekti i rivlerësimit përmes ankimit, si dhe të evidentojë pasojat juridike që i gjykon të përshtatshme, duke mos përjashtuar mundësinë e arritjes në ndonjë prej përfundimeve të parashikuara nga neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, si normë e referuar në vendimin e Komisionit, pra se kemi të bëjmë me fshehje pasurie. Vëzhguesi ndërkombëtar gjithashtu thekson të shtojë se Komisioni në vendim, nuk përjashton plotësisht mundësinë që subjekti i rivlerësimit të jetë realisht pronari përfitues i kësaj pasurie. Jurisprudenca e Kolegjit duhet të zhvillohet në lidhje me rastet e pasurive në përdorim, për të cilat mungojnë provat e burimeve të ligjshme të blerjes, por njëkohësisht mungon edhe një përfundim lidhur me fshehjen e pasurive. Përfundimi i përgjithshëm *in abstracto*, siç dhe sugjerohet në disa vendime të Kolegjit, se raste të tilla nuk mund të kenë pasoja negative për subjektin e rivlerësimit, do të ishte një pohim *a priori* që nuk konsideron siç duhet kuptimin që neni D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës i vesh përdorimit të pasurisë, krahasuar me pronësinë e pasurisë. Vëzhguesi ndërkombëtar gjykon se në raste të tilla, Kolegjit i del për detyrë që të kryejë një vlerësim të duhur proporcional dhe holistik të rrethanave specifike të rastit (duke shqyrtuar elemente si cilësia dhe çmimi i pasurisë/sendit në përdorim, ekskluziviteti i përdorimit, kohëzgjatja e përdorimit), me qëllim që të përcaktojë si peshën ekonomike të përdorimit të pasurisë, ashtu dhe impaktin të vlerësimi i përgjithshëm i subjektit të rivlerësimit.

10. Në kushtet kur *Opinionit* i sipërcituar i vëzhguesit ndërkombëtar u paraqit në fazën procedurale në të cilën gjykata ishte tërhequr në dhomë këshillimi për marrjen e vendimit përfundimtar, trupi gjykues, bazuar në nenin 315 të Kodit të Procedurës Civile, vendosi të revokojë vendimin e ndërmjetëm për përfundimin e hetimit gjyqësor dhe rihapjen e tij, me qëllim marrjen në shqyrtim në gjykimin e çështjes të *Opinionit* me shkrim të dhënë nga vëzhguesi ndërkombëtar

dhe vënien e tij në dispozicion të subjektit të rivlerësimit. Në seancën gjyqësore publike të datës 12.04.2022, subjekti i rivlerësimit, pasi ishte njohur me *Opinionin* e vëzhguesit ndërkombëtar, përsëriti qëndrimin e tij, ashtu sikurse në parashtrimet e paraqitura në seancën gjyqësore publike të datës 17.03.2022, duke pretenduar se ka sqaruar në mënyrë të detajuar, marrëdhënien e qirasë që ka pasur për periudhën janar 2011 deri në shtator 2017, në adresën e banimit në rr. “{***}”, Tiranë, arsyet që kanë çuar në transferimin në këtë apartament, si dhe faktin se, në funksion të transparencës së plotë me organet e rivlerësimit dhe opinionin publik, ka paraqitur provat e plota, të cilat provojnë burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për financimin e apartamentit. Gjithashtu, subjekti parashtron se Komisioni gjatë hetimit administrativ, ka kryer një hetim të thelluar dhe nuk ka rezultuar asnjë dyshim për ndonjë situatë të mundshme të fshehjes së pasurisë nga ana e subjektit të rivlerësimit. Aktet e administruara në këtë çështje, të cilat konsistojnë në: i) kontratën e porosisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.09.2010, nënshkruar mes babait të subjektit dhe shoqërisë “{***}” ShPK; ii) komunikimet shkresore të Komisionit me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Drejtorinë e Ujësjetllës Kanalizimeve Tiranë, të cilat vërtetojnë se kontratat e furnizimit janë në emër të z. B. I.; iii) komunikimin shkresor me Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, ku nuk rezulton asnjë pasuri e padeklaruar nga subjekti i rivlerësimit, provojnë se kjo pasuri ka qenë e babait të tij. Në kuadër të *Opinionit* të vëzhguesit ndërkombëtar, subjekti i rivlerësimit çmon se në rastin e tij, nuk jemi në asnjë situatë të mundshme të fshehjes së pasurisë dhe, me të drejtë, Komisioni nuk ka aluduar apo hedhur dyshime për fshehje pasurie.

B. Vlerësimi i Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë

11. Trupi gjykues i Kolegjit kontrollon vendimin e Komisionit mbi shkaqet e ankimit të ngritura nga subjekti i rivlerësimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, si kriter i vetëm mbi të cilin, në zbatim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka marrë vendimin për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Fatri Islamaj.

*Për pasurinë në emër të babait të subjektit të rivlerësimit, apartament me sipërfaqe 100 m², i ndodhur në rr. “{***}” (ish-{{***}}), kompleksi “{***}”, Tiranë*

12. Komisioni, për këtë pasuri, ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi çmon se për apartamentin me sip. 100 m², ndodhur në rr. “{***}”, Tiranë, të përdorur prej tij (para dhe pas deklaratës “vetting”), nuk arriti të sigurojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj pasurie.
13. Lidhur me këtë apartament, të ndodhur në rr. “{***}” (ish-{{***}}), kompleksi “{***}”, Tiranë, të përdorur nga subjekti i rivlerësimit për periudhën 2011-2017, ai kundërshton konkluzionet e Komisionit në vendim për detyrimin ligjor ngarkuar subjektit të rivlerësimit për të justifikuar burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie, si dhe mbi mundësinë financiare të babait të tij, në cilësinë e kryefamiljarit për blerjen e këtij apartamenti.
14. Subjekti i rivlerësimit, në ankim, pretendon se Komisioni ka bërë një interpretim të gabuar të nenit 3, pika 14, nenit 32, pika 4 dhe nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, duke i kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të një apartamenti të përdorur kundrejt qirasë, të cilin subjekti nuk e ka në pronësi, posedim apo përdorim, si dhe nuk gëzon të drejta reale mbi të. Konsiderimi i babait të subjektit, person tjetër i lidhur në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, duke e çmuar marrëdhënien të paktën si huapërdorje sipas nenit 901 e vijues të Kodit Civil, është haptazi i pabazuar në prova dhe në kundërshtim të hapur me jurisprudencën e Kolegjit. Në analizë të këtyre shkaqeve ankimore, trupi gjykues, konstaton se:

14.1. Komisioni, për këtë pasuri, ka arritur në përfundimin se, duke analizuar konkluzionet e arritura në raport me njëra-tjetrën, krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit ishte në thelb duke përdorur një apartament, para dhe pas dorëzimit të deklaratës të pasurisë “vetting”, për të cilin nuk arriti të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit. Komisioni në vendim ka arsyetuar se për shkak se konsiderohet i provuar fakti i përdorimit të apartamentit për një periudhë të gjatë kohore, prej 6 vjetësh, çmon se kjo marrëdhënie duhet të konsiderohet të paktën si një marrëdhënie huapërdorjeje, sipas parashikimeve të nenit 901 e vijues të Kodit Civil, e cila përfshihet te marrëdhëniet e huas që parashikon neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, marrëdhënie e cila e kategorizon babanë e subjektit në këtë rast, si person tjetër të lidhur, dhe passjell detyrimin e subjektit të rivlerësimit për të provuar burimin e ligjshëm të kësaj pasurie.

14.2. Subjekti i rivlerësimit, si gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, ashtu dhe në ankimin e parashtrimet e tij përpara Kolegjit, pretendon se përdorimi prej tij i këtij apartamenti, ka qenë kundrejt një marrëdhënieje qiraje, dhe se referuar parashikimeve të nenit 4, pika 1, germa “h” e ligjit nr. 9049/2003, nuk ka pasur detyrimin ligjor të deklarojë marrëdhënien e qirasë me babain për faktin se vlera e qirasë nuk kalon shumë mbi 300.000 lekë në vit, për t’u konsideruar shpenzim i deklarueshëm. Subjekti i rivlerësimit pretendon gjithashtu se marrëdhëniet e qirasë konfirmohet nëpërmjet deklaratave noteriale¹¹ të depozituara në Komision, të cilat në kuptim të neneve 233, germa “ç”, 253 dhe 257 të Kodit të Procedurës Civile kanë vlerë të plotë provuese, fakti i deklarimit të kësaj marrëdhënieje në deklaratën e pasurisë “vetting”, si dhe pohimet e tij gjatë procesit të rivlerësimit që, bazuar në parashikimet e nenit 214 të Kodit të Procedurës Civile, kanë vlerën e provës, përputhen në harmoni me provat e tjera në funksion të vërtetimit të këtij fakti të ekzistencës së marrëdhënies së qirasë.

14.3. Lidhur me formalizimin e kësaj marrëdhënieje, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se sipas parashikimit të nenit 803 të Kodit Civil, kontrata e qirasë nuk është një kontratë e cila kërkon formën si kusht vlefshmërie. Kontrata e qirasë është ripërsëritur verbalisht, me dakordësi të përbashkët çdo vit [2011-2017], për shkak dhe të një marrëdhënieje të posaçme besimi [prind -fëmijë]. Pasi kaloi një periudhë prej rreth 5 vitesh, datë 27.09.2016, marrëdhëniet e qirasë u formalizua me shkrim, në përputhje me parashikimet e nenit 803, paragrafët 2 dhe 4 të Kodit Civil. Formalizimi i një marrëdhënieje juridiko-civile midis prindit dhe fëmijës në kuadër të këtij procesi, nuk duhet vlerësuar si shkak për fshehjen e ndonjë marrëdhënieje, por duhet vlerësuar si përpjekje për të qenë sa më i saktë dhe, për efekt provueshmërie, përpara organeve kompetente.

14.4. Komisioni në vendim, për këtë apartament, arsyeton se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk e bindën se realisht mes tij dhe babait ka pasur një marrëdhënie qiraje verbale, e cila mbështetet në mirëkuptim deri në vitin 2016. Deklarata noteriale e babait, sipas Komisionit, nuk mund të konsiderohet si provë e fortë, referuar kohës kur është deklaruar, si dhe marrëdhënies së posaçme mes tyre. Fakti, sipas Komisionit, që palët kanë vendosur të lidhin një kontratë në vitin 2016¹², që korrespondon me miratimin e ligjit të *vetting*-ut, nuk e bindën se ishte një marrëdhënie kontraktore në vazhdimësi, duke theksuar edhe faktin që subjekti i rivlerësimit nuk ka siguruar ndonjë dokumentacion financiar (mandatarkëtim, transfertë bankare ose pagesa të taksave), për të provuar qiranë ndaj babait. Komisioni krijon bindjen se afati 5-vjeçar i kontratës së qirasë që u zbatua për më pak se një vit, është lidhur pikërisht për të justifikuar marrëdhënien pararendëse të parregulluar dhe provuar si një marrëdhënie korrekte qiramarrjeje. Sipas të dhënave të mbledhura, Komisioni ka konstatuar se ky apartament është blerë nga babai i subjektit të rivlerësimit dhe është përdorur vetëm prej

¹¹ (1) Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.09.2016, të z. B. I. dhe z. Fatri Islamaj.; (2) deklaratë noteriale nr. {***} rep., datë 12.02.2019, e z. B. I.; (3) deklaratë noteriale nr. {***} rep., datë 26.05.2019, e z. B. I.; (4) deklaratë noteriale nr. {***} rep., datë 01.12.2019, e A., A., F. e F. I.

¹² Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.09.2016, e deklaruesve B. I. dhe F. I.

subjektit të rivlerësimit për një periudhë të gjatë kohore dhe, pavarësisht këtij fakti, subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar ndër vite, deri në datën 27.9.2016, e cila korrespondon me ligjin e *vetting*-ut.

14.5. Trupi gjykues analizoi fillimisht faktin nëse jemi përpara një marrëdhënieje qiraje, siç e pretendon subjekti, gjatë procesit të rivlerësimit, apo në kushtet e aplikimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, të konkluduar nga Komisioni në vendim. Nga kontrolli mbi vendimin objekt shqyrtimi, trupi gjykues konstaton një qëndrim kontradiktor i Komisionit, pasi nga njëra anë i kalon subjektit të rivlerësimit barrën e provës për burimin e ligjshëm të apartamentit të babait të tij, duke e konsideruar *person tjetër të lidhur*, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, dhe nga ana tjetër përfshin në analizën financiare¹³, në zërin shpenzime: “*Shpenzime qiraje ap., rr. “{***} [...]”* për periudhën 2011 – 2016, shumën 180.000 lekë për çdo vit respektivisht, duke konfirmuar kështu marrjen në konsideratë të marrëdhënies së qirasë, ndërkohë që në paragrafin 87, nënparagrafi i pestë i vendimit të ankimuar, e konsideron marrëdhënien si huapërdorje, ndërsa në nënparagrafin e tretë të paragrafit 87 të këtij vendimi, arsyetohet se shpjegimet e subjektit nuk e bindën se realisht mes subjektit dhe babait ka pasur një marrëdhënie qiraje verbale.

14.6. Nga analizimi i deklaratës së pasurisë *vetting*, rezulton se apartamenti i përdorur nga subjekti i rivlerësimit, është deklaruar në rubrika të ndryshme të deklaratës së pasurisë *vetting*, konkretisht: i) si adresë e vendqëndrimit tjetër, ku banon subjekti i rivlerësimit, ka deklaruar: *rruga “{***}” (ish-***), kompleksi {***}, shkalla {***}, kati {***}, ap. {***}*; ii) në rubrikën e përshkrimit të pasurisë dhe burimit të krijimit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *apartament banimi i porositur me kontratën e sipërmarrjes nr. {***} rep., {***} kol., dt. 18.03.2016 [...], i ndodhur në rr. “{***}”, i blerë totalisht me kredinë bankare nr. {***} rep., {***} kol., dt 24.03.2016. Ky apartament është akoma i pabanueshëm dhe banoj në adresën e deklaruar, apartament i marrë me qira prindërve të deklaruesit, në vlerën 15.000 lekë në muaj, sipas kontratës nr. {***} rep., {***} kol., dt. 27.09.2016*; iii) si dhe në rubrikën e përshkrimit të detyrimeve financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, ku deklaron: “*Banoj në një apartament 100 m², me qira në adresën: rruga “{***}” (quajtur dhe rruga “{***}”), kompleksi {***}, kati {***}, ap. {***}, sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.09.2016, me vlerë qiraje 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj”*.

14.7. Me aktet shkresore bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit depoziton dhe një deklaratë noteriale¹⁴ të babait të subjektit të rivlerësimit dhe vetë subjektit në cilësinë e qiradhënësit dhe qiramarrësit, për apartamentin me sipërfaqe 100 m², të ndodhur në rr. “{***}”, Tiranë, për një afat 5-vjeçar, nga data 29.08.2016 deri më datë 29.08.2021, në vlerën 15.000 lekë në muaj.

14.8. Nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore, rezulton se apartamenti i ndodhur në rrugën “{***}” (ish-***), kompleksi {***}, Tiranë, ku subjekti i rivlerësimit ka banuar në periudhën janar 2011 deri nëntor 2017, është përfituar nga babai i subjektit të rivlerësimit, z. B. I., nëpërmjet kontratës së porosisë për investim e dorëzim apartament banimi dhe vend parkim (garazh) nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.09.2010. Z. B. I., në cilësinë e porositësit, nënshkruan këtë kontratë me sipërmarrësin, shoqërinë “{***}” ShPK, me objekt një apartament banimi, me përbërje 2+1, kati i gjashtë, me sipërfaqe 100 m², në vlerën 65.000 euro, prej të cilave 50.000 euro paguhen ditën e nënshkrimit të kontratës dhe pjesa tjetër prej 15.000 eurosh do të paguhet me regjistrimin e pasurisë në hipotekë.

¹³ Shih tabelën në faqen 34 të vendimit nr. 220, datë 10.12.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

¹⁴ Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.09.2016, e z. B. I. dhe z. Fatri Islamaj.

14.9. Në kuadër të hetimit administrativ, pas kërkesës¹⁵ së Komisionit, ILDKPKI-ja, me shkresën nr. {***} prot., datë 15.07.2019, ka përcjellë procesverbalin “Mbi shpjegimet e subjektit të deklaramit të pasurive”, datë 30.10.2014, ku pyetjes së inspektorese së ILDKPKI-së, se: *referuar deklaramimeve të interesave privatë, nga viti 2005 deri në 31.12.2013, nuk rezulton të keni deklaruar pasuri të paluajtshme. Mund ta na thoni se ku banoni*, subjekti i rivlerësimit i përgjigjet se nuk disponon pasuri të paluajtshme. Nga viti 2004, ka jetuar te shtëpia e prindërve të bashkëshortes të cilët jetonin në Amerikë, dhe nga viti 2011 është zhvendosur dhe jeton tek apartamenti i prindërve të tij, në rrugën “{***}”, Tiranë, si banim i përkohshëm. Ky apartament, sipas subjektit, është blerë nga prindërit e tij dhe nuk është i regjistruar në hipotekë.

Ndërsa, sa i përket burimit të krijimit të vlerës sipas kontratës së porosisë, si dhe faktin se kur është bërë i banueshëm dhe sa ka kushtuar mobilimi i këtij apartamenti, subjekti i rivlerësimit i përgjigjet se burimi janë kontributet e dy vëllezërve të tjerë, F. I. dhe F. I., dhe motra A. I., e cila nga viti 2001 ka jetuar në Angli. Subjekti i rivlerësimit sqaron se dy vëllezërit janë në përbërje familjare bashkë me prindërit, ndërsa subjekti është veçuar që nga viti 2007, kur është martuar. *Këto vlera janë kursime për një periudhë të gjatë dhe nuk janë kryer me transferta bankare, por nga ardhjet e vazhdueshme të vëllezërve dhe motrës nga viti 2000 e në vazhdim. Referuar kontratës së porosisë, është paguar vetëm vlera 50.000 euro, kurse shuma prej 15.000 eurosh nuk është likuiduar ende pasi është kusht që kjo vlerë do paguhet me hipotekimin e apartamentit [...]. Ky apartament është bërë i banueshëm nga ana e prindërve të mi para se të bëhej kontrata dhe në vitin 2011, jam transferuar unë, kur nuk më është dashur të kryej shumë shpenzime për mobilimin e tij, pasi ka qenë pothuajse i mobiluar.*

14.10. Duke marrë shkas nga deklarimi në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe në përgjigjet e pyetësorëve gjatë hetimit administrativ në Komision, nga analizimi i deklaratave të interesave privatë, rezulton që ky apartament nuk është deklaruar si adresë banimi në deklaratat e interesave privatë 2011-2013, ndërkohë është deklaruar nga viti 2014 e në vazhdim.

14.11. Gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se pagesa e qirasë është bërë me para në dorë te prindërit si qiradhënës. Për shkak të marrëdhënies së posaçme të besimit me qiradhënësin, për periudhën janar 2011 deri shtator 2016, nuk është bërë kontratë e shkruar për qiranë. Si provë në mbështetje të argumenteve të tij, subjekti i rivlerësimit i referohet deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.02.2019 dhe deklaratës noteriale nr. {***} rep., datë 26.05.2019 të qiradhënësit B. I.. Sipas subjektit, për këtë marrëdhënie qiraje, nuk është bërë kontratë me shkrim, duke pasur parasysh që nuk ishte element detyrues dhe nuk kërkohej nga asnjë parashikim ligjor kjo formë kontrate. Subjekti i rivlerësimit në vijim shpjegon se, referuar vlerës së përcaktuar në nenin 4, germa “c” e ligjit nr. {***}, datë 10.04.2003, të shtuar dhe të ndryshuar me ligjin nr. 85/2012 dhe nr. 45/2014, nuk ka pasur detyrimin të deklarojë shpenzimin e pagesës së qirasë, rreth 180.000 lekë në vit. Si provë për këtë fakt, subjekti i rivlerësimit shpjegon se janë deklarimet e tij gjatë hetimit administrativ dhe tri deklaratat noteriale të babait të tij, të datave 27.09.2016, 12.02.2019 dhe 26.05.2019 [të përmendura në poshtëshënim nr. 11].

14.12. Kolegji, nisur nga rrethanat dhe faktet e bëra me dije nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit gjyqësor, si dhe aktet e depozituara prej tij në Komision, arrin në përfundimin se mes babait të subjektit të rivlerësimit dhe subjektit të rivlerësimit nuk ka pasur një marrëdhënie qiraje për përdorimin e apartamentit të ndodhur në rr. “{***}”, kompleksi “{***}”, Tiranë. Konkluzioni i trupit gjykues të Kolegjit, mbështetet në këtë arsyetim:

Së pari, duke mbajtur në konsideratë deklarimet e subjektit të rivlerësimit dhe familjarëve të tij nëpërmjet deklaratave noteriale të depozituara në Komision, trupi gjykues vëren se mes babait

¹⁵ Me shkresën nr. {***} prot., datë 10.07.2019, “Kërkesë për informacion dhe dokumentacion”.

të subjektit të rivlerësimit dhe vëllëzërve të subjektit, ekziston ndjenja e mbështetjes reciproke të fëmijëve ndaj prindërit dhe anasjellas. Ky fakt konstatohet konkretisht në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.02.2019, të z. B. I., në të cilën deklarohet se si burim krijimi për financimin e blerjes së dy apartamenteve në kompleksin “{***}”, rr. “{***}”, Tiranë, kanë shërbyer kursimet e tij dhe kryesisht kursimet e fëmijëve të tij në emigracion, të cilët i kanë sjellë në shtëpi [F., F., A. dhe A.]. Ky fakt është mbështetur më pas në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.12.2019, të A. I., A. I., F. I. dhe F. I., nëpërmjet së cilës konfirmojnë plotësisht deklarin e bërë nga babai i tyre, se që të katërt e kanë mbështetur financiarisht babain për blerjen e apartamenteve në rr. “{***}”, Tiranë. Ky fakt theksohet dhe nga subjekti i rivlerësimit në parashtrimet e tij gjatë seancës gjyqësore të datës 12.04.2022 në Kolegj, i cili shprehet se qëndrimi në këtë kompleks banimi, ku jetonin dhe prindërit e tij, bëhej dhe për të mbajtur një marrëdhënie familjare me prindërit, në përputhje me kulturën e tyre, duke krijuar dhe lidhjen sentimentale dhe kulturore mes nipit dhe gjyshërve, si aspekte të rëndësishme social-kulturore të familjes së tyre. Pra, në këto kushte, në vlerësim të trupit gjykues, është e vështirë të arrihet në një konkluzion që një familje me tradita, unitet dhe pozitë të mirë financiare, siç pretendohet nga subjekti i rivlerësimit, të mund t’i jepte apartament me qira në vlerën 15.000 lekë të birit, subjektit të rivlerësimit Fatri Islamaj.

Së dyti, siç rezulton nga qëndrimet e mbajtura nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, konkretisht sipas procesverbalit “Mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurive”, datë 30.10.2014, ku subjekti i rivlerësimit ka sqaruar që nga viti 2011 është zhvendosur dhe jeton tek apartamenti i prindërve në rrugën “{***}” Tiranë, si banim i përkohshëm. Nëse subjekti i rivlerësimit do të ishte duke përdorur këtë apartament në kushtet e një marrëdhënieje qiraje, ky fakt do të ishte deklaruar prej tij para ILDKPKI-së që në këtë vit, gjë që do ta bënte të besueshëm këtë pretendim gjatë procesit të rivlerësimit.

Së treti, nuk provohet me asnjë dokument, që subjekti i rivlerësimit të ketë paguar detyrimin financiar për këtë marrëdhënie qiraje.

14.13. Sa i përket vlerësimit të Komisionit se marrëdhënia mes subjektit të rivlerësimit dhe babait të tij duhet të konsiderohet të paktën si një marrëdhënie huapërdorjeje, sipas përcaktimit të nenit 901 e vijues të Kodit Civil, e cila përfshihet te marrëdhënia e huas që parashikon neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, dhe e kategorizon babain e subjektit si person tjetër të lidhur, fakt që passjell detyrimin e subjektit të rivlerësimit për të provuar burimin e ligjshëm, qëndrim i konsideruar nga subjekti i rivlerësimit haptazi i pabazuar në prova dhe në kundërshtim të hapur me jurisprudencën e Kolegjit, trupi gjykues vlerëson se:

14.14. Në kuptim të përkufizimit për “*persona të tjerë të lidhur*”, të dhënë nga neni 3, pika 14¹⁶ e ligjit nr. 84/2016, që personi tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit të konsiderohet i tillë, duhet të provohet një lidhje interesi mes tyre, që vjen si pasojë e: i) një interesi pasuror; ose ii) çdo marrëdhënieje tjetër biznesi. Ligji nr. 84/2016, në nenin 3, pika 9 e tij ka parashikuar se çfarë konsideron “marrëdhënie biznesi” në kuadër të këtij procesi, duke e përkufizuar si: [...] *çdo marrëdhënie profesionale ose tregtare, e cila lidhet me veprimtaritë e ushtruara nga subjektet e këtij ligji dhe klientët e tyre, që, në çastin e vendosjes së saj, vlerësohet të jetë një marrëdhënie e vazhdueshme ose jo, sipas ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit*, gjë që nuk gjen zbatim në rastin konkret. Ndërsa lidhja e interesit që rrjedh nga një interes pasuror është përcaktuar në nenin 32, pika 4 e këtij ligji, i cili parashikon se: “*Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto*

¹⁶ Neni 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016, parashikon: “*“Persona të tjerë të lidhur” janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin ose komisionerin publik që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi”*”.

marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive”, për të cilën Kolegji ka një qëndrim të konsoliduar tashmë në jurisprudencën¹⁷ e tij, i sjellë si argument në mbështetje të pretendimeve të tij edhe nga subjekti i rivlerësimit gjatë parashkrimeve në Kolegj.

14.15. Në analizë të konsiderimit të marrëdhënies së përdorimit të apartamentit nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se Komisioni ka konstatuar saktë ekzistencën e një marrëdhënieje përdorimi të këtij apartamenti nga subjekti i rivlerësimit për periudhën 2011-2017, por gabon në kualifikimin e kësaj marrëdhënieje si nënkategori e parashikuar nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, që çon subjektin e rivlerësimit në detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj pasurie sipas këtij parashikimi ligjor. Vlerësimin e tij lidhur me përdorimin e apartamentit të babait të subjektit pa pagesë qiraje, Kolegji e ka trajtuar në vendimin nr. 7, datë 24.06.2020, ku në paragrafin 94 të tij ka arsyetuar se: *lidhur me përdorimin prej subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, të apartamentit të babait të tij, z. M.K., pa pagesë qiraje, trupi gjykues, edhe pse mban në konsideratë faktin që mbështetja që i është dhënë subjektit të rivlerësimit nga babai i tij, z. M.K., si më sipër, mund të trajtohet teorikisht si një përfitim monetar (shumë e pashpenzuar për qëllime qiraje banimi) dhe, si rrjedhojë, do të mund të vendoste palët në një marrëdhënie interesi pasuror sipas parashikimeve të nenit 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016, arrin në përfundimin se nëse gjatë kontrollit të kësaj pasurie, nuk arrihet në një konkluzion në kuadër të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, në drejtim të tentativës për të fshehur pasurinë (duke qenë se për shkak të marrëdhënies së ngushtë familjare dyshimi për konflikt të mundshëm interesi nuk ekziston), atribuimi i mungesës së burimeve të ligjshme të babait të subjektit, për të justifikuar krijimin e pasurisë së paluajtshme apartament me sip. 135 m² dhe dy garazhe me sip. 18 m², subjektit të rivlerësimit, në kuadër të lidhjes që ekziston mes tyre për përdorim të përbashkët të banesës, pa qira, do të tejkalonte objektin e procesit të rivlerësimit.*

14.16. Në mbështetje të situatës faktike dhe juridike të sipërcituar, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur detyrim ligjor në kuptim të nenit 3, pika 14 dhe neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, për të provuar burimin e ligjshëm të krijimit të apartamentit të përdorur prej tij, për periudhën janar 2011 deri në nëntor 2017, pasi babai i subjektit nuk plotëson kërkesat e këtyre dispozitave ligjore për t’u konsideruar person tjetër i lidhur, që do ta vendosnin përpara këtij detyrimi, i cili konsiderohet në tejkallim të parashikimeve kushtetuese e ligjore. Për sa më sipër, trupi gjykues gjen të bazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit, se konsiderimi i babait të tij person tjetër i lidhur, në kuptim të ligjit të posaçëm, nuk gjen mbështetje ligjore.

- 15.** Pavarësisht sa më sipër arsyetuar, Kolegji, në kuadër të parashikimit në nenin D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, vlerëson se Komisioni, lidhur me pasuritë në përdorim të subjekteve të rivlerësimit, ka detyrimin të analizojë dhe evidentojë saktë marrëdhënien juridike që lidh subjektin e rivlerësimit me pasurinë në përdorim, në drejtim të verifikimit të çdo fakti apo rrethane që mund të ngrëjë dyshime për fshehjen apo paraqitjen në mënyrë të pasaktë të pasurive në përdorim të tij, që mund të rezultojnë të jenë krijuar nga vetë subjekti i rivlerësimit. Në rastin objekt shqyrtimi, pavarësisht se trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se Komisioni ka konstatuar saktë ekzistencën e një marrëdhënieje përdorimi, në kuadër të një vendimmarrjeje sa më të drejtë, pas administrimit të provave të depozituara nga subjekti i rivlerësimit dhe në analizë të shkaqeve të ankimit të subjektit të rivlerësimit, vendosi të verifikojë konkluzionin e Komisionit në vendim se: *[...] subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr.*

¹⁷ Shih, vendimin nr. 7, datë 24.06.2020, paragrafët 93 e 94; vendimin nr. 20, datë 08.09.2020, paragrafët 21 – 21.4; vendimin nr. 21, datë 10.09.2020, paragrafët 72 – 75 e 77; vendimin nr. 4, datë 09.02.2021, paragrafët 143 – 146.

84/2016 [...], pasi për apartamentin me sip. 100 m², ndodhur në rr. “{***}”, Tiranë, të përdorur prej tij (para dhe pas deklaratës “vetting”), nuk arriti të sigurojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj pasurie.

16. Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se ka vënë në dispozicion të Komisionit të gjitha provat dhe shpjegimet me të cilat vërtetohet se babai i tij, kur ka porositur apartamentin, ka pasur burime të ligjshme financimi për krijimin e pasurisë me vlerën 50.000 euro [kësti i paguar në datën e nënshkrimit të kontratës së porosisë]. Nga analiza e provave të administruara, subjekti i rivlerësimit pretendon se është tërësisht e provuar mundësia financiare me burime të ligjshme të ardhurave të kryefamiljarit B. I. dhe anëtarëve të familjes së tij për blerjen e apartamentit në vitin 2010, mundësi e cila tejkalon disa herë vlerën e apartamentit. Në analizë të këtij shkakut ankimor, trupi gjykues konstaton si vijon.

16.1. Komisioni në vendim, lidhur me justifikimin e ligjshmërisë së burimit të krijimit të këtij apartamenti, ka konstatuar se të ardhurat e deklaruara të vëllezërve dhe të motrës mund të tregojnë potencialisht mundësinë e tyre për të pasur të ardhura, por nuk rezultoi e provuar se kanë paguar tatime për të ardhurat, gjithashtu nuk u provua në ndonjë mënyrë bindëse se ia kanë dhënë të ardhurat babait të tyre. Gjithashtu, Komisionit nuk iu duk bindës fakti se ata mund të kenë financuar në blerjen e një apartamenti në emër të babis të tyre, i cili as nuk është përdorur prej tij dhe as ata si financues nuk kanë pretenduar bashkëpronësinë. Trupi gjykues, nga analizimi i vendimit të Komisionit, nuk konstaton që prej tij të jetë bërë një analizë e mirëfilltë financiare për të provuar mundësinë e babait të subjektit në cilësinë e kryefamiljarit, për të blerë më 23.09.2010, apartamentin e përdorur nga subjekti i rivlerësimit.

16.2. Kolegji, mbi bazën e provave të administruara në këtë çështje nga subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, kreu analizën financiare të babait të subjektit të rivlerësimit B. I., në cilësinë e kryefamiljarit dhe anëtarëve të tjerë të familjes, prej fillimit të vitit 2000, për të cilin evidentohen të dhëna nga provat e administruara për të ardhurat e familjarëve deri më datë 23.09.2010, kur është porositur apartamenti nga babai i subjektit, nëpërmjet kontratës së porosisë për investim e dorëzim apartamenti banimi dhe vendi parkimi (garazh) nr. {***} rep., nr. {***} kol.. Në këtë analizë financiare, janë përfshirë z. B. I. dhe familjarët e tij, bashkëshortja M. I., dhe vëllezërit e subjektit të rivlerësimit F. I., A. I. dhe F. I., të cilët, sipas certifikatë e përbërjes familjare të depozituar në Kolegj nga subjekti i rivlerësimit, rezultojnë që deri më datë 01.01.2011, të kenë qenë në të njëjtin trung familjar. Ndërsa motra e subjektit të rivlerësimit, znj. A. I., e cila gjithashtu rezulton anëtare e familjes për periudhën e analizuar, nuk është përfshirë në këtë përlllogaritje, për shkak se ka jetuar në Mbretërinë e Bashkuar që prej vitit 2001, si dhe nuk është paraqitur dokumentacion ligjor për të ardhurat e saj. Subjekti i rivlerësimit nuk është përfshirë gjithashtu në këtë përlllogaritje, pasi është shkëputur nga trangu familjar në tetor 2007 për shkak të martesës, ndërkohë që ka bashkëjetuar me znj. M. I. që prej dhjetorit 2005, dhe nuk ka deklaruar ndonjëherë se ka kontribuar financiarisht për krijimin e kësaj pasurie, as në deklaratimet para ILDKPKI-së në vitin 2014¹⁸, e as gjatë procesit të rivlerësimit.

17. Për të konkluduar, në lidhje me mundësinë financiare të babait të subjektit, në cilësinë e kryefamiljarit, trupi gjykues analizoi vendimin e Komisionit objekt shqyrtimi, në raport me shkaqet e ankimit të ngritura nga subjekti i rivlerësimit dhe aktet shkresore në cilësinë e provës të administruara në këtë çështje.
18. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, se Komisioni nuk ka marrë në konsideratë të ardhurat që kanë shërbyer si burim financimi të qiradhënësit B. I., si të ardhurat e kontribuesit kryesor të kësaj pasurie që janë ato të vëllait të tij F. I. nga kontratat e shitjes së kuotave, fakte

¹⁸ Sipas procesverbalit “Mbi shpjegimet e subjektit të deklaratimit të pasurive”, datë 30.10.2014, përcjellë nga ILDKPKI me shkresën nr. {***} prot., datë 15.07.2019.

të cilat janë zyrtarisht të provuara dhe të publikuara në institucione të administratës publike, si Qendra Kombëtare e Biznesit dhe regjistri tregtar i saj, si dhe të ardhurat nga ushtrimi i aktivitetit profesional si inxhinier dhe aktivitet tregtar si person fizik i regjistruar, dhe si ortak e administrator i shoqërisë tregtare {***}, në Zyrih, para vitit 2010, trupi gjykues konstaton si vijon.

18.1. Gjatë hetimit administrativ, në përgjigjet e datës 14.02.2019 dhe bashkëlidhur shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit më datë 20.11.2019, subjekti i rivlerësimit ka depozituar: i) vendimin nr. {***} regj., datë 15.02.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për regjistrimin e shoqërisë “{***}” ShPK, me NIPT {***}, me ortak të vetëm F. I., me kapital themelor të shoqërisë 5.000.000 lekë, me objekt ruajtjen dhe sigurimin e personave fizikë, objekteve publike dhe private të personave fizikë dhe juridikë, shoqërimin e vlerave monetare etj; ii) kontratën e shitjes së kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë “{***}” ShPK nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.07.2006, me shitës F. I. dhe blerës B. B. dhe D. V., për shitjen e 49% të kapitalit themeltar, në masën 490 kuota, në vlerën 5.000 lekë për kuotë, totali 2.450.000 lekë; iii) vendimin nr. {***}, datë 16.04.2007, të ortakëve të shoqërisë për miratimin e shitjes së kuotave në masën 51% që zotëron z. F. I. në këtë shoqëri, blerëses M. B., si dhe largimin e tij nga detyra e administratorit; iv) kontratën e shitjes së kuotave të shoqërisë “{***}” ShPK nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.04.2007, me shitës F. I. dhe blerëse M. B.; objekti i kontratës: shitja e 51% të kuotave të kësaj shoqërie, në vlerën 64.000 euro.

18.2. Në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.02.2019, të shtetasit F. I., depozituar nga subjekti i rivlerësimit në Komision, deklarohet se për shkak të mosprezencës së tij në Shqipëri, për arsye të impenjimeve në Zvicër, i ka shitur kuotat e mbetura prej 51%, znj. M. B., në vlerën 64.000 euro, *shuma të paguara në llogarinë bankare pranë Bankës Italo-Shqiptare*. Sipas deklaruesit, këto shuma, si dhe kursimet e tjera të sjella nga puna në Zvicër, janë investuar në Shqipëri, nga ai vetë dhe babai B. I., një pjesë e tyre është përdorur për ta ndihmuar edhe për pagesën e prenotimit të dy apartamenteve në kompleksin “{***}” Tiranë.

18.3. Mbi qëndrimin e Komisionit se nuk dokumentohet pagesa e çmimit të shitjes së kuotave, në analizë të pretendimit të subjektit se ky qëndrim është rezultat i çmuarjes së gabuar të provave, interpretim i gabuar i ligjit procedural, si dhe vjen në kundërshtim me vendimin nr. 5, datë 18.02.2019, të Kolegjit, paragrafi 35, pjesa e parë, trupi gjykues vlerëson se shitjet e kuotave të kapitalit janë kryer me anë të kontratave të nënshkruara para noterit dhe, në kuptim të nenit 690, të Kodit Civil, *kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të prishet ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve ose për shkaqe të parashikuara me ligj*, si dhe konsiderohen akte zyrtare, bazuar në përcaktimet e nenit 253 të Kodit të Procedurës Civile, i cili përcakton se: *Aktet zyrtare që përpilohen nga nëpunësi i shtetit ose personi që ushtron veprimtari publike, brenda kufijve të kompetencës së tyre dhe në formën e caktuar, përbëjnë provë të plotë të deklarimeve që janë bërë përpara tyre për faktet që kanë ngjarë në prani të tyre ose për veprimet e kryera prej tyre. Lejohet të provohet e kundërta vetëm kur pretendohet se shkresa është e falsifikuar*. Sa më sipër, kontratat noteriale të shitblerjes së kuotave, si specifikuar më sipër, përbëjnë provë të plotë, gjë që përforcohet nga parashikimi i nenit 257 të këtij kodi, sipas të cilit, *shkresat që përpilohen në bazë të nenit 253 për kryerjen ose vërtetimin e veprimit juridik, për sa u përket deklarimeve të palëve, përbëjnë provë të plotë për të gjithë*.

18.4. Nga aksesimi i faqes zyrtare në internet të Qendrës Kombëtare të Biznesit [QKB], rezulton se në ekstraktin historik të shoqërisë “{***}” ShPK [NIPT {***}], pas depozitimit të kontratës së shitblerjes së kuotave, përpiluar më datë 25.07.2006, me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., dhe kontratës së shitblerjes së kuotave nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.04.2007, janë reflektuar ndryshimet përkatëse. Fakti që në QKB janë bërë ndryshimet respektive, tregon që kontratat e shitjes së kuotave të kësaj shoqërie, janë ekzekutuar për sa i

përket humbjes së të drejtave të pronësisë mbi kuotat e z. F. I., duke u kaluar blerësve dhe duke konfirmuar në këtë mënyrë zbatimin e tyre dhe krijimin e pasojave juridike të dëshiruara nga palët. Në këto kushte, duke qenë se nuk rezulton asnjë e dhënë që kontrata të jetë ekzekutuar vetëm në drejtim të përfitimit të të drejtave të njëres palë, ekziston prezumimi ligjor se edhe çmimi i përcaktuar në të është paguar sipas përcaktimit të kontratës. Mënyra e pagesës humbet relevancën, sa kohë që nuk ka dyshime mbi mënyrën e ekzekutimit të kontratës.

18.5. Për më tepër, në kushtet kur pagesa për shitjen e kuotave nuk ka qenë detyrim të kryhej nëpërmjet llogarive bankare për personat fizikë jotregtarë, si parashikuar në nenin 52/1 të ligjit nr. 8560, datë 22.12.1999, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, sipas të cilit: *Kryerja me lekë në dorë e transaksioneve të shitblerjes, që kalon shumën 500 mijë lekë për vitin 2004 dhe 300 mijë lekë për vitet në vijim, duke përjashtuar personat fizikë jotregtarë, përbën shkelje si për shitësin, edhe për blerësin dhe secili prej tyre dënohet me një gjobë të barabartë me 5 për qind të vlerës së transaksionit të kryer, trupi gjykues vlerëson se z. F. I., në cilësinë e shitësit në këto kontrata, si individ [person fizik jotregtar], nuk ka pasur pengesa në kryerjen me lekë të dorë të këtyre transaksioneve. Pavarësisht se kontrata e shitjes së kuotave ka pasur të parashikuar mënyrën e pagimit të vlerës së shitjes nëpërmjet llogarisë bankare, në vlerësim të Kolegjit, jo domosdoshmërisht mospagimi sipas kësaj mënyre, të çon në vlerësimin që pagesa nuk është kryer.*

18.6. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson që pretendimi i subjektit të rivlerësimit, *se qëndrimi i Komisionit se nuk dokumentohet pagesa e çmimit të shitjes së kuotave, është rezultat i çmuarjes së gabuar të provave dhe interpretim i gabuar i ligjit procedural dhe jurisprudencës e Kolegjit, qëndron.*

18.7. Në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, *pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji, konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore.* Që të ardhurat e z. F. I., të përfituara nga shitja e kuotave të shoqërisë “{***}” ShPK, të konsiderohen të ligjshme në kuptim të këtij procesi, duhet të provohet pagesa e detyrimit tatimor. Referuar nenit 8, pika 1, germa “f” e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale, konsiderohen si të ardhura të tatueshme: *të ardhurat e realizuara nga diferenca ndërmjet çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes së kuotave ose aksioneve, që një ortak ose aksioner zotëron dhe ia shet një personi tjetër.*

Nga përmbajtja e kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.07.2006, me anë të së cilës janë tjetërsuar 49% e kuotave të kapitalit fillestar të investuar në shoqëri nga F. I., në vlerën 2.450.000 lekë, rezulton se nuk ka ndryshim mes vlerës fillestare të investuar për këto kuota [49% e kapitalit fillestar 5.000.000 lekë = 2.450.000 lekë] dhe çmimit të shitjes së tyre. Në këto kushte, të ardhurat nga shitja e këtyre kuotave, për të cilat nuk parashikohet detyrim tatimor, duhet të përfshihen në analizën financiare si të ardhura të ligjshme.

Nëpërmjet kontratës shitje kuotash të shoqërisë “{***}” ShPK, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.04.2007, z. F. I., në cilësinë e shitësit, i shet pjesën e mbetur prej 51% të kuotave të tij në këtë shoqëri, blerëses M. B., në vlerën 64.000 euro. Mënyra e pagesës, sipas përcaktimit në nenin 2 të kontratës, do të bëhej në katër këste, me vlerën 16.000 euro secila, në numrin e llogarisë bankare pranë Bankës Italo-Shqiptare.

18.8. Subjekti i rivlerësimit në ankim pretendon se përpara se të vlerësohet se sa ka qenë fitimi i realizuar nga shitja e kuotave, duhet të bëhet vlerësim a ka pasur apo jo fitim. Sipas subjektit, z. F. I., në cilësinë e ortakut, nga momenti i themelimit të shoqërisë me kapital themeltar 5.000.000 lekë, ka bërë dhe investime të tjera, si kreditime të vetë ortakut, të pasqyruara në librat kontabël të shoqërisë. Pra, ortakët e kësaj shoqërie kanë vendosur që t’i kthejnë vlerën e financimeve/kreditimeve shtesë ortakut F. I., me anë të kontratës së vitit 2007

dhe jo duke ndjekur rrugën e rritjes formale të kapitalit dhe zmadhimit të vlerës nominale para se të bëhej kontrata e shitjes, siç është përcaktuar në nenin 3, germa “c” e saj.

18.9. Sa i përket këtij pretendimi, nga analizimi i *kontratës së shitjes së kuotave nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.04.2007*, në nenin 3, pika “c” e saj, parashikohet se: [...] *shitësi deklaron se nuk ka asnjë pretendim tjetër ekonomik ndaj shoqërisë, si financim ortakësh, të bërë në këtë shoqëri, përveç asaj të parashikuar në nenin 2 a) për shumën e shitjes prej 64.000 eurosh, siç kanë rënë dakord palët*. Nga leximi i këtij përcaktimi dhe atij në nenin 2, germa “a”, se kuotat e shitësit F. I., në masën 51%, do të blihen nga blerësja M. B., në çmimin 64.000 euro, rezulton se në këtë çmim janë përfshirë dhe investimit e ortakut F. I. në këtë shoqëri. Megjithatë, ky fakt nuk e përjashton vëllain e subjektit të rivlerësimit nga detyrimi për të paguar tatimin mbi të ardhurat nga diferenca e çmimit të shitjes së 51% të kuotave të kapitalit, në vlerën 64.000 euro, me çmimin e blerjes tyre, në vlerën 2.550.000 lekë [51 % x 5000 lekë/kuotë]. Për më tepër, kur në kushtet e kontratës nuk është specifikuar që shitësi shet 51% të kuotave në vlerën e blerjes së tyre, 2.550.000 lekë, dhe pjesa tjetër, si diferencë e mbetur nga 64.000 euro, të përbëjë financimin e bërë nga ortakut F. I. në këtë shoqëri.

18.10. Lidhur me pretendimin e subjektit se *F. I. ka qenë fillimisht administrator i shoqërisë dhe një tjetër mënyrë e rritjes së kapitalit të shoqërisë ka qenë fakti që nuk është marrë vendim për ndarje dividendi, fakt që provohet nga bilanci i shoqërisë, si dhe kreditime të tilla nga ortakut e rrisin në mënyrë automatike kapitalin e shoqërisë, por nuk pasqyrohen si rritje e vlerës nominale të kuotës, pa bërë një procedurë formale të zmadhimit të kapitalit të shoqërisë*, nga analizimi i dokumentacionit të shoqërisë të administruar në dosje, si dhe i informacionit të publikuar në faqen zyrtare në internet të QKB-së, rezulton se zmadhimi i kapitalit për këtë shoqëri është bërë me vendimin nr. {***}, datë 24.12.2008, të Asamblesë së Ortakëve, ndërkohë që kuotat ishin shitur më datë 16.04.2007. Megjithatë, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit *për zmadhimin faktik të kapitalit, por jo të pasqyruar me një vendim formal, si rrjedhim blerësja ka paguar vlerën reale të kontributeve të ish-ortakut, duke përfshirë dhe financimet e tij, për pasojë nuk rezulton që ortakut të ketë pasur ndonjë diferencë fitimi në shitjen e kuotave* – nuk përjashton shitësin e kuotave, në këtë rast z. F. I., nga pagesa e detyrimit tatimor mbi të ardhurën nga diferenca e çmimeve.

18.11. Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se aktet ligjore e nënligjore që parashikojnë detyrimin tatimor për shtimin e kapitalit me burime nga jashtë shoqërisë, janë parashikuar pas shitjes së kuotave nga vëllai i tij, konkretisht neni 8, germa “h”¹⁹ e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar me ligjin nr.10228, datë 4.2.2010, nuk përfshin rastin e shitjes së këtyre kuotave, pasi ky transaksion është bërë në prill 2007. Po kështu edhe udhëzimi nr. 5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, nuk parashikon tatim mbi të ardhurat që kanë shërbyer për rritjen e kapitalit të shoqërisë. Ky udhëzim ka ndryshuar lidhur me këtë pikë me udhëzimin nr. 16, datë 25.07.2012, pra shumë kohë pasi z. F. I. kishte shitur kuotat. Lidhur me këtë pretendim, trupi gjykues vlerëson se detyrimi tatimor në ngarkim të shtetasit F. I., nuk i referohet tatimit mbi shtimin e kapitalit me burime nga jashtë shoqërisë, parashikuar nga dispozitat e sipërcituara [neni 8, pika 1, germa “h” e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, dhe pika 2.3.10 e udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006], por tatimit mbi diferencën e çmimit të blerjes dhe shitjes së kuotave, referuar neni 8, pika 1, germa “f”²⁰ e ligjit nr. 8438,

¹⁹ Neni 8, pika 1, germa “h” e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, parashikon: “h. të ardhurat në formë monetare për shtimin e kapitalit me burime nga jashtë shoqërisë, që nuk janë të tatuara më parë, ndërkohë që kanë qenë objekt tatimi dhe që nuk janë të shoqëruara me dokumente zyrtare, që vërtetojnë origjinën e këtyre të ardhurave”.

²⁰ Neni 8, pika 1, germa “f” e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, parashikon: “të ardhurat e realizuara nga diferenca ndërmjet çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes së kuotave ose aksioneve, që një ortak ose aksioner zotëron dhe ia shet një personi tjetër”.

datë 28.12.1998 dhe pikës 2.3.8, pika 1, germa “a” e udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006²¹, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

18.12. Subjekti i rivlerësimit në ankim pretendon se, edhe sikur të mos kishte dalë ligji i amnistisë fiskale që ka bërë faljen e detyrimit tatimor të papaguar nga individët, referuar dispozitave ligjore të miratuara pas shitjes së kuotave nga i vëllai F. I., nuk duhet ta kishin çuar Komisionin në një hipotezë negative. Konkretisht, sipas subjektit, referuar neneve 73²² dhe 100²³ të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohet se, me kalimin e afatit prej 5 vitesh për të drejtën e institucioneve tatimore për vjeljen e detyrimeve tatimore dhe për fillimin e procedurave për këtë qëllim, tatimpaguesi nuk ka asnjë detyrim për të paguar ndonjë tatim për shkak të efekteve të parashkrimit shues. Si rrjedhim, nuk mund të konsiderohet si subjekt që nuk ka paguar tatimin. Komisioni, sipas subjektit, duhej të mbante në konsideratë faktin se katër vite pas shitjes së kuotave, është miratuar ligji nr. 10418, datë 21.04.2011, “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor”, në nenin 19 të të cilit parashikohet se falen pa pagesë në favor të Buxhetit të Shtetit. Edhe sikur F. I. të kishte pasur ndonjë detyrim tatimor për këto kuota, ato konsiderohen të paguara për shkak të ligjit (*ex lege*). Në respektim të nenit 49, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, ky është një fakt juridik i njohur dhe nuk ka nevojë të provohet. Në vlerësim të trupit gjykues, argumentet ligjore të përmendura nga subjekti i rivlerësimit në këtë pretendim, konsiderohen irelevante, pasi në kuptim të nenit D, pika 3, konsiderohen të ardhura të ligjshme ato për të cilat janë paguar detyrimet tatimore dhe jo ato për të cilat detyrimet mund të jenë shuar apo falur për efekt të një akti ligjor apo nënligjor të mëvonshëm.

18.13. Me parashtrime “*shtesë ankimi*”, depozituar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 29.09.2021, subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni i Komisionit për të mos marrë parasysh të ardhurat nga kontrata nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.04.2007, është i pabazuar për të gjitha shkaqet e ngritura në ankim, edhe për faktin se nuk provohet që vëllai i subjektit të mos ketë paguar tatimin në burim për diferencën e të ardhurave të realizuara nga shitja. Individu, sipas subjektit, nuk mund të penalizohet vetëm për shkak se nuk disponon të ruajtur dokumentacionin tatimor, të cilin nuk ka pasur detyrimin ta ruajë, që sipas subjektit as institucioni shtetëror nuk e disponon. Me këto parashtrime, subjekti i rivlerësimit depoziton komunikimin shkresor të z. F. I. me Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë, për vërtetimin e pagesës së tatimit mbi të ardhurat: a) *kërkesën e datës 10.02.2021* dhe b) *shkresën nr. {***} prot., datë 19.07.2021, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, sipas së cilës nuk ka të dhëna për subjektin F. I. me ID {***}, për pagesën e tatimit në burim për të ardhurat e realizuara nga diferenca e shitjes së kuotave*, akte të risjella nga subjekti i rivlerësimit dhe në Kolegj.

Subjekti i rivlerësimit në vijim, i referohet nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, se ndodhet në kushtet e pamundësisë objektive për të disponuar dokumentin që provon pagimin e tatimit në burim për fitimin e realizuar nga shitja e kuotave të shoqërisë nga vëllai.

²¹ Pika 2.3.8 e udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006, pika 1 germa “a”, që parashikon: “2.3.8 Të ardhurat e realizuara nga diferenca ndërmjet çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes së kuotave të pjesëmarrjes në kapital apo të aksioneve. Në këtë grup përfshihen të ardhurat e realizuara nga shitja e kuotës që një ortak zotëron në një biznes apo ortakëri, apo të ardhurat e realizuara nga shitja e aksioneve. Ndryshe nga grupet e tjera, baza tatimore në këtë rast është diferenca midis: 1. të ardhurave nga shitja apo likuidimi i biznesit me vlerën e kontributit në para ose natyrë të ortakëve; a) të ardhurave nga shitja e kuotës së pjesëmarrjes në kapital me vlerën nominale ose të blerjes së kuotës.

²² Neni 73, pika e 1 ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, parashikon: “1. E drejta e administratës tatimore për të bërë një vlerësim tatimor parashkruhet brenda 5 vjetëve nga data e fundit e dorëzimit të deklaratës tatimore, të përcaktuar në legjislacionin tatimor përkatës”.

²³ Neni 100, pika 1 e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, e drejta për fillimin e procedurave për zbatimin e masave shtrënguese, sipas këtij kreu, parashkruhet brenda 5 viteve nga data kur detyrimi tatimor i papaguar duhej të kryhej.

18.14. Në lidhje me të ardhurat nga *kontrata e shitjes së kuotave nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.04.2007*, në vlerën 64.000 euro, trupi gjykues kontaton se: i) kjo kontratë e lidhur para noterit, përbën një akt zyrtar dhe provë të plotë për faktin e shitjes së këtyre kuotave; ii) pagesa e kësteve të çmimit të shitjes së kuotave sipas kontratës është kryer nëpërmjet *llogarisë bankare të z. F. I.*; iii) kontrata është depozituar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, duke sjellë efektet e saj në reflektimet dhe ndryshimet përkatëse pranë këtij institucioni, [informacion lehtësisht i aksesueshëm në faqën zyrtare të internetit], dhe sipas përcaktimeve të nenit 21, pika 5 të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” i ndryshuar, *regjistrimet e regjistrimit tregtar vlerësohen gjithnjë të njohura dhe përbëjnë akt zyrtar për autoritetet publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi*; iv) F. I. nuk ka qenë subjekt deklarues pranë ILDKPKI-së në periudhën e shitjes së kuotave.

Edhe pse nga aktet e dosjes nuk provohet që për këtë të ardhur të jetë depozituar dokumentacion për pagesën e tatimit mbi diferencën e çmimit të shitjes së kuotave me atë të blerjes së tyre [64.000 euro shitje dhe 2.550.000 lekë blerje], duke pasur parasysh jurisprudencën²⁴ e Kolegjit, nuk mund të mos merret në konsideratë të paktën vlera e 51% të kuotave prej 2.550.000 lekësh, të investuara fillimisht nga F. I. në shoqëri, për këto kuota. Për këto arsye, në analizën financiare të kryer në Kolegj, është përfshirë në përllogaritje vlera 2.550.000 lekë.

18.15 Lidhur me të ardhurat e z. F. I., nga ushtrimi i aktivitetit profesional si inxhinier dhe aktivitet tregtar si person fizik “{***}” dhe si ortak e administrator i shoqërisë tregtare {***}, në Zyrih, trupi gjykues, pas administrimit në cilësinë e provës të akteve të depozituara nga subjekti i rivlerësimit në seancën e datës 15.03.2022, konstaton se në dokumentin “*Ekstrakt nga llogaria personale nr. {***}*” të z. F. I., të lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore Zyrih, Zvicër, më datë 25.06.2010, rezulton se për periudhën 2002 – 2007, të ketë përfituar në total 249.847 CHF [franga zvicerane]. Në kushtet kur në këtë ekstrakt nuk është përcaktuar nëse këto të ardhura janë bruto apo neto, në Kolegj u konsideruan bruto dhe, për llogaritjen neto të tyre, u zbrit tatimi mbi të ardhurën personale në masën 40%²⁵. Për efekt të analizës financiare të kryer në Kolegj, shpenzimet jetike të z. F. I. për këtë periudhë, janë përllogaritur sipas të dhënave të “*Federal Statistical Office, Household Expenditure*”, për Zvicrën, ku niveli i shpenzimeve për konsum familjar përllogaritet në masën 63% për të ardhur mesatare mujore 5.630 franga zvicerane [CHF] për moshën deri në 34 vjeç.

18.16 Lidhur me të ardhurat e z. F. I. nga bashkëpunimi me shoqërinë {***} ShPK, me seli në Prishtinë, Koovë, si agjent i kësaj shoqërie në Shqipëri për periudhën 2010 – 2012, Komisioni në vendim ka konstatuar se: *nuk vërtetohen të ardhurat e përfituara nga ky bashkëpunim dhe as pagesa e tatimeve përkatëse*. Ky konkluzion është kundërshtuar nga subjekti i rivlerësimit, duke pretenduar të ketë paraqitur dokumentacion ligjor që provon faktin se F. I. ka pasur një marrëdhënie (kontratë) shërbimi si përfaqësues/agjent tregtar ekskluziv i kësaj shoqërie në Shqipëri, në vitet 2010, 2011, 2012. Trupi gjykues konstaton se subjekti, me përgjigjet e datës 14.02.2019 të pyetësorit të Komisionit, ka depozituar disa akte shkresore²⁶ të cilat nuk japin të

²⁴ *Shih vendimin nr. 11, datë 22.05.2019, paragrafi 27.12.12, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit [subjekti i rivlerësimit Edmond Islamaj]: “[...] trupi gjykues arrin në përfundimin se pretendimi i Komisionerit Publik është pjesërisht i bazuar në ligj, vetëm për vlerën e fitimit të realizuar nga shitja e automjeteve (diferenca mes çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes së automjetit), për sa kohë nuk u provua pagimi i detyrimit tatimor mbi këtë fitim. Për rrjedhojë, vlera e fitimit të realizuar vlerësohet si e ardhur e paligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016 dhe kjo vlerë iu zbrit së ardhurës të arkëtuar nga shitja e këtyre automjeteve, duke u pasqyruar në rezultatin financiar të vitit përkatës”.*

²⁵ <https://tradingeconomics.com/switzerland/personal-income-tax-rate>.

²⁶ i. *Autorizim, datë 10.01.2011, i shoqërisë {***} ShPK, me të cilin z. F. I. autorizohet të përfaqësojë këtë kompani në të gjitha veprimet dhe marrëdhëniet e saj kontraktuale me kompaninë {***} ShA*; ii. *dokument i datës 01.02.2019, “Konfirmim për marrëdhënie shërbimi”, të lëshuar nga administratori i saj, në të cilin konfirmohet se z. F. I. ka shërbyer si agjent tregtar i shoqërisë në Prishtinë, në mbulimin e marrëdhënieve me furnitorët në Shqipëri dhe ka nënshkruar kontrata furnizimi në emër dhe për llogari të shoqërisë tregtare {***}*

dhëna financiare mbi të ardhurat/pagat e përfituara nga F. I. si agjent tregtar pranë kësaj shoqërie. Për këtë arsye, trupi gjykues vlerëson të drejtë qëndrimin e Komisionit në vendim.

19. Lidhur me të ardhurat e vëllait të subjektit A. I., Komisioni ka konstatuar se, përveç provave të depozituara deri në datën 20.11.2019, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur edhe një vërtetim nr. {***} prot., datë 22.11.2019, nga shoqëria “{***}” ShA, ku përcaktohet paga bruto dhe tatimi i mbajtur mbi pagën për të vëllanë, për periudhën 2000 – 2013, por nuk evidentohet shuma neto e përfitur prej tij çdo vit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur, sipas Komisionit, provohet se të ardhurat neto nga paga e z. A. I. për periudhën 2000 – 2009, kanë qenë në vlerën 11.440.787 lekë.
20. Subjekti i rivlerësimit në ankim ka kundërshtuar këtë konstatim të Komisionit, duke pretenduar se: *qëndrimi i Komisionit lidhur me vërtetimin nr. {***} prot., e datës 22.11.2019, për të ardhurat e vëllait A. I., është i kundërligjshëm dhe tendencioz, i cili duhet të korrigjohet nga Kolegji. Ky vërtetim përshkruan për secilin vit të ardhurat bruto dhe tatimin e mbajtur mbi pagën. Vetëm paga e A. I., sipas subjektit, është më shumë se dyfishi i vlerës së apartamentit të blerë në 2010. Komisioni nuk merr në konsideratë të ardhurat e A. I., duke u nisur nga fakti se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasqyruar këto të ardhura në deklaratimin e bërë në tetor 2014 para specialistes së ILDKPKI-së, si një nga burimet e të ardhurave të babait. Në analizë të këtyre pretendimeve, trupi gjykues konstaton si vijon.*

20.1. Nga shqyrtimi i akteve të dosjes gjyqësore, rezulton se në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.02.2019, B. I. deklaron se djali i madh A. I., ka qenë në emigracion në ShBA (New York dhe New Jersey) në periudhën 1994 – 1999, pasi është kthyer, ka punuar pa shkëputje deri së fundmi, në punë me pagesë të konsiderueshme. Nga viti 2001 deri në vitin 2013, ka punuar pranë shoqërisë shtetërore ANTA (Agjencia Nacionale e Trafikut Ajror) ShA, me të ardhura mujore të konsiderueshme.

20.2. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit të datës 20.11.2019, subjekti i rivlerësimit sqaron se z. A. I. ka qenë i pamartuar deri në vitin 2012, duke paraqitur bashkëlidhur shpjegimeve dhe 4 vërtetime të tij për pagën për periudhën 2000 e në vazhdim, që sipas subjektit të rivlerësimit, rezulton me të ardhura 10.000.000 lekë në 10 vitet e fundit, derisa është blerë apartamenti. Në vërtetimin për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, të lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore për periudhën 3 janar 2000 deri më 13 nëntor 2013, jepen të dhëna për pagën bruto dhe neto nga puna pranë shoqërisë “{***}” ShA. Gjatë seancës dëgjimore të datës 03.12.2019, subjekti i rivlerësimit depoziton vërtetimin nr. {***} prot., datë 22.11.2019, të lëshuar nga shoqëria “{***}” ShA, në të cilën vërtetohet se A. I. ka qenë punonjës pranë shoqërisë, me detyrë ekspert, Sektori i Ekspertëve ATM, Divizioni Operacional, për periudhën 03.01.2000 deri më 13.11.2013, duke specifikuar për çdo vit totalin e pagës bruto dhe tatimin e mbajtur.

Në parashtrimet me shkrim gjatë seancës dëgjimore të datës 03.12.2019, subjekti i rivlerësimit sqaron se: *arsyeja përse po paraqes një vërtetim të ri të pagesës së vëllait, A., si provë, është pasi konstatoj se të ardhurat që ai ka marrë pranë shoqërisë “{***}” ShA (ish-ANTA ShA) janë shumë më të larta sesa ato që reflektonin vërtetimet e Drejtorisë së Sigurimeve Shoqërore, të paraqitura nga ana ime më datë 20.11.2019. Ky ndryshim mendoj që vjen për shkak se është*

*përgjatë viteve 2010, 2011, 2012; iii. disa kontrata blerjeje ndërmjet {***} ShA dhe {***} ShPK, përfaqësuar nga F. I., datë 25.07.2011, 22.07.2011, 06.08.2012; iv. Kontratë Blerje dhe Ekskluziviteti, datë 16.10.2012, ndërmjet {***} and {***} ShA dhe shoqërisë {***} ShPK, përfaqësuar nga F. I.*

paguar edhe me honorare dhe shpërblime të larta, të cilat nuk janë reflektuar në regjistrat e DRSSH-së, ku pasqyrohet paga bazë. Nga ky vërtetim i datës 22.11.2019, rezulton që vëllai i madh, A. I., është paguar me një pagë neto prej 15.821.961 lekësh, nga viti 2000 deri në vitin 2010 dhe jetonte në një familje me prindërit.

20.3. Në analizë të shkaqeve ankimore, fakti që subjekti i rivlerësimit në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja, më datë 30.10.2014, ka sqaruar se burimi janë kontributet e dy vëllezërve të tjerë, F. I. dhe F. I., duke sqaruar se dy vëllezërit janë në përbërje familjare bashkë me prindërit, duke mos përmendur këtu si kontribues dhe vëllain A. I., në vlerësim të Kolegjit, nuk përbën shkak për përjashtimin e të ardhurave të tij, pasi ai ka qenë anëtar i familjes I. në momentin e blerjes së apartamentit objekt analize dhe, në referencë të jurisprudencës së Kolegjit për raste të ngjashme²⁷, duhet trajtuar në kushtet e ekonomisë së përbashkët familjare. Sa u përket të ardhurave nga punësimi i z. A. I. pranë shoqërisë “{***}” ShA, trupi gjykues vlerëson se ato duhet të konsiderohen sipas vërtetimit nr. {***} prot., datë 22.11.2019, pasi ky është një dokument i ligjshëm, i lëshuar nga institucioni punëdhënës dhe që përmban të dhëna më të plota nga ato të pasqyruara në vërtetimet e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, pasi vërteton të ardhurat reale të përfituara nga A. I., përfshirë honoraret, shpërblimet etj., të cilat konsiderohen të ardhura të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Referuar të dhënave në këtë vërtetim, rezulton se totali i të ardhurave nga pagat për periudhën janar 2000 deri në gusht 2010, përlllogaritet në vlerën 14.056.623 lekë (paguar kontributet dhe tatimet).

20.4. Sa i përket qëndrimin të Komisionit në vendim, se nga hetimi ka rezultuar se z. A. I. ka blerë deri në vitin 2010 pasuri në emër të tij, duke përdorur pjesërisht të ardhurat e tij dhe pjesërisht kredi bankare, duke mos e bindur se të ardhurat e shtetasit A. I. nga shoqëria “{***}” ShA kanë qenë të mjaftueshme për të blerë pasuri në emër të tij dhe për të kontribuar për blerjen e apartamentit objekt analizimi, subjekti i rivlerësimit e kundërshton, duke e konsideruar të gabuar dhe të pabazuar në prova. Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se shpenzimet të A. për banesën e vet, janë shlyer thujse me kredi nga banka dhe vetëm 6% e vlerës së apartamentit, 3.000 euro, është paguar nga kursimet e veta. Lidhur me këtë pretendim, nga aktet e dosjes rezulton se gjatë periudhës deri në blerjen e apartamentit objekt shqyrtimi, A. I., nëpërmjet kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.08.2007, ka porositur një apartament nga shoqëria ndërtimore “{***}” ShPK, në vlerën 46.890 euro, nga të cilat ka paguar 3.000 euro, ditën e nënshkrimit të kontratës, ndërsa këstin e fundit, 43.890 euro, me marrjen e kredisë dhe para dorëzimit të apartamentit.

Në analizën financiare të kryer në Kolegj, është përfshirë kostoja e apartamentit të porositur nga A. I. në vitin 2007, në vlerën 46.890 euro, ashtu edhe kredia e përfituar prej tij nga Alpha Bank ShA, për këtë qëllim, në shumën 36.000 euro, me kontratën për kufi kredie shumëqëllimore nr. {***}, datë 03.12.2007. Gjithashtu, në analizën financiare të këtij viti [2007], është përfshirë edhe kostoja e apartamentit me sipërfaqe 90 m², me vlerë 56.700 euro²⁸,

²⁷ Shih vendimin nr. 18, datë 26.07.2019 dhe vendimin nr. 22, datë 22.07.2021 (paragrafi 28.2) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

²⁸ Referuar deklaratës noteriale nr. {***} rep., kol., datë 12.02.2019, B. I. deklaroi se ka paguar për këtë apartament shumën 49.000 euro në datën e porosisë dhe pjesën tjetër para se ta shiste këtë apartament në vitin 2017, pa u bërë regjistrimi i objektit në ZRPP, për shkak të vonësave nga ndërtuesi. Për këtë, kanë hartuar kontratën e revokimit nr. {***} rep./kol., datë 06.04.2017.

porositur më datë 13.10.2007, si deklaroi B. I. në *deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.02.2019*, i ndodhur në të njëjtën godinë banimi me apartamentin e përdorur nga subjekti i rivlerësimit.

21. *Lidhur me të ardhurat vëllait të subjektit, F. I.*, Komisioni në vendim ka arsyetuar se subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kopje të dokumentacionit (jo në formën e kërkuar nga ligji), si dhe ka provuar marrëdhënien e punësimit të vëllait F. I. pranë AKSHI-t²⁹, në periudhën 2008 – 2014, por nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor justifikues në lidhje me shumën totale të të ardhurave të përfituara prej tij dhe as të pagesës së tatimeve mbi këto të ardhura.

22. Subjekti i rivlerësimit në ankim ka pretenduar se, për të ardhurat e z. F. I., Komisioni nuk i ka kërkuar që të paraqesë prova më të sakta apo më të plota, si detyrim që Komisioni ka pasur në rast se nuk ka krijuar bindjen për këto të ardhura. Në momentin e përgatitjes së rezultateve të hetimit administrativ, Komisioni duhej t'i bënte të ditur këtë fakt subjektit që po i nënshtrohet procesit të rivlerësimit. Në analizë të këtyre pretendimeve, trupi gjykues konstaton se:

22.1. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e datës 14.02.2019 të pyetësorit të Komisionit, ka depozituar kopje të librezës së punës, sipas së cilës z. F. I. ka qenë i punësuar për periudhën 07.02.2008 deri më 06.01.2014, pranë Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, si dhe një vërtetim nr. {***} prot., datë 18.04.2012, të AKSHI-t, i cili vërteton se z. F. I. është i punësuar në pozicionin Specialist pranë kësaj agjencie dhe paguhet me pagë mujore bruto 93.880 lekë, dhe neto 74.670 lekë.

22.2. Me rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni i ka kërkuar subjektit të *depozitojë dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat që kanë shërbyer për blerjen e pasurisë apartament banimi me sipërfaqe 100 m², ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, porositur nga babai në vitin 2010, të përdorur nga ana juaj për vitet 2011 – 2017*. Në kushtet kur Komisioni nuk ka kryer një analizë financiare për mundësinë e z. B. I., në cilësinë e kryefamiljarit, për të blerë më datë 23.09.2010, apartamentin e përdorur nga subjekti, ku do të gjenin pasqyrim të gjithë zërat e analizës [të ardhura/shpenzime/detyrime/pasuri], subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur me shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, dokument ligjor për vlerën e saktë të të ardhurave nga punësimi, të z. F. I..

22.3. Në analizën financiare të kryer në Kolegj, u morën në konsideratë të ardhurat e z. F. I., sipas vërtetimit nr. {***} prot., datë 18.03.2020, të lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, të administruar në cilësinë e provës në seancën gjyqësore publike të datës 15.03.2022. Sipas të dhënave të këtij vërtetimi, të ardhurat neto të z. F. I. për periudhën 01.02.2008 deri më 31.10.2010, rezultojnë: viti 2008, në shumën 755.473 lekë; viti 2009, në shumën 855.262 lekë; dhe viti 2010, në shumën 724.640 lekë. Në total, rezulton se për periudhën 01.02.2008 (nga dita e emërimit) deri gusht 2010, para blerjes së apartamentit objekt shqyrtimi, z. F. I. ka realizuar të ardhura në vlerën 2.093.828 lekë. Nga dokumentacioni i administruar në fashikullin gjyqësor, rezulton që z. F. I. dhe z. B. I. të kenë pasur llogari të përbashkëta në Bankën Intesa SanPaolo ShA³⁰, lëvizjet e të cilave u analizuan në Kolegj, dhe ndryshimi i gjendjes së likuiditeteve të tyre u konsiderua në analizën financiare të kryer në

²⁹ Akronim – Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.

³⁰ Përcjellë Komisionit nga Intesa Sanpaolo Bank ShA, me shkresën nr. {***} prot., datë 04.01.2019.

Kolegj, në vlerësimin e mundësisë së familjes I. për të krijuar kursime në shumën 50.000 euro për likuidimin e këstit 50.000 euro të apartamentit të porositur më 23 shtator 2010.

22.4. Për kryefamiljarin B. I. dhe bashkëshorten e tij M. I., janë konsideruar të ardhurat nga pensioni i pleqërisë, provuar me vërtetimet e lëshuara nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore me nr. {***} prot., dhe nr. {***} prot., datë 13.11.2019.

23. Kolegji, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, kreu analizën financiare për periudhën 01.01.2000 deri më 23.09.2010, për të verifikuar mundësinë e babait të subjektit të rivlerësimit, në kuadër të regjimit të përbashkët familjar, për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 100 m², përdorur nga subjekti i rivlerësimit për periudhën 2011-2017. Rezultatet e analizës financiare të kryer pas administrimit të provave të depozituara nga subjekti, me qëllim kontrollin e konkluzionit të Komisionit për pamundësinë e z. B. I. për të mbuluar me burime të ligjshme krijimin e pasurisë apartament që ishte në përdorim të subjektit, treguan se ky konkluzion i Komisionit nuk qëndron, pasi babai dhe anëtarët e familjes së tij, në kuadër të regjimit të përbashkët familjar, kanë rezultuar me mjaftueshmëri të burimeve financiare të ligjshme për të paguar shumën 50.000 euro, për këtë apartament objekt analize, në datën 23.09.2010.

Në përfundim të sa arsyetuar më sipër, Kolegji konstaton që nuk ka pasaktësi në deklaram, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, si parashikuar në konkluzionin e Komisionit për këtë pasuri.

Për llogarinë bankare të përbashkët në monedhën lek, që bashkëshortja e subjektit ka pasur me vëllain e saj në “Intesa Sanpaolo Bank”

24. Komisioni, në vendim, ka dalë në konkluzionin se personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit (bashkëshortja) nuk ka deklaruar në deklaratën “vetting” (dorëzuar më 25.1.2017) një llogari bankare të përbashkët me vëllain e saj, për të cilën Komisioni ka hetuar disa depozita ndër vite, si dhe ligjshmërinë e burimit të krijimit.
25. Subjekti i rivlerësimit në ankim pretendon se: i) nuk ka pasur dijeni për këtë llogari bankare; ii) gjendja e kësaj llogarie justifikohet me burime të ligjshme; iii) pas datës 10.03.2008, nuk janë kryer veprime bankare nga bashkëshortja e subjektit në këtë llogari; iv) prej bashkëshortes së subjektit janë kryer vetëm 4 derdhje [*veprime bankare*], tri para martese, me gjendje të papërfillshme monetare në raport me të ardhurat e saj dhe nuk ka kryer tërheqje; v) kjo llogari e përbashkët bankare rezulton e papërdorur nga bashkëshortja rreth 9 vite para dorëzimit të deklaratës “vetting”; vi) mosdeklarimi i kësaj llogarie, është për shkak të harresës dhe jo i vetëdijshëm. Trupi gjykues, në analizë të këtyre pretendimeve, konstaton sa vijon.

25.1. Nga analizimi i vendimit objekt shqyrtimi, rezulton se Komisioni ka mbajtur një qëndrim kontradiktor, pasi për këtë llogari, në paragrafët 154 deri 157 të vendimit, nuk konstaton problematika lidhur me mundësinë financiare të personit të lidhur për shumat e depozituara në këtë llogari, duke përfshirë në analizën financiare si pasuri të bashkëshortes së subjektit, gjysmën e gjendjes së saj në fund të çdo viti, ndërkohë që në konkluzionin e kriterit të pasurisë, e përfshin këtë fakt si një nga arsyet e zbatimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

25.2. Në kuadër të hetimit administrativ, Komisioni administroi shkresën nr. {***} prot., datë 04.01.2019, të Bankës Intesa SanPaolo ShA, e cila informon se personi i lidhur M. I. ka *pasur llogari të përbashkët [nr. {***}, Base Number]*.

25.3. Nga lëvizjet e kësaj llogarie bankare [nr. {***}] në lekë, rezulton se më datë 14.08.2006, është depozituar nga znj. M. I. shuma 90.415 lekë, më datë 20.11.2006; është depozituar shuma 40.000 lekë, më datë 10.07.2007; shuma 20.000 lekë, më datë 07.08.2007 dhe 13.08.2007 janë tërhequr nga z. A. L. shumat 50.000 lekë dhe 35.000 lekë përkatësisht; më datë 10.03.2008, është depozituar nga M. I. vlera 10.000 lekë; tërhequr nga z. A. L. më 05.09.2008, shuma 30.000 lekë, më pas të gjitha veprimet në këtë llogari [depozitime/ tërheqje] janë bërë nga z. A. L., si dhe nga data 20.06.2013 e në vazhdim në këtë llogari është transferuar nga minibashkia nr. 9 “*Ndih+Paaftësi (Verber+Tetraplegjike)*” dhe “*Ndihmë ekonomike*” për z. D. L. [babai i bashkëshortes së subjektit] deri më datë 30.09.2015. Lëvizja e fundit në këtë llogari rezulton e kryer nga z. A. L., tërheqje 84.400 lekë, më datë 20.10.2015, ndërkohë që në fund të vitit 2018 kjo llogari rezulton ende e hapur, me gjendje 22 lekë.

25.4. Në përgjigjet e datës 15.10.2019 të pyetësorit të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se para se të martohet, bashkëshortja e tij ka hapur këtë llogari të përbashkët me vëllanë e saj A. L., i cili ishte në emigracion, me qëllim për t’i ardhur në ndihmë të vëllait për veprime të ndryshme në Tiranë. Depozitimet e bëra pas martesës nuk ishin të bashkëshortes, por të familjes së saj dhe nuk është konsideruar pasuri e bashkëshortes dhe, për pasojë, ajo nuk e ka deklaruar në deklaratën fillestare të vitit 2007. Subjekti i rivlerësimit shpjegon se nga janari 2008, ka paguar qira për apartamentin e ndodhur në rrugën “{***}”, kompleksi “{***}”, kati 9, në pronësi të babait të bashkëshortes D. L., i cili për shkak të marrëdhënieve familjare ia ka kaluar pronësinë të birit A. L., i cili e kishte ndihmuar në blerjen e apartamentit. Me pagesën e qirasë së këtij apartamenti, është marrë bashkëshortja dhe është dakordësuar me babain dhe vëllain e saj që depozitimet e bëra para martesës të mos tërhiqen prej saj, por t’i lihen A. si vlerë e qirasë për periudhën 2008 e në vazhdim. Sipas subjektit, kjo llogari ka shërbyer edhe për të depozituar pensionin e invaliditetit të z. D. L., tërhequr nga i biri A. L.. Gjatë gjithë kohës, llogaria është përdorur nga i vëllai, për këtë arsye sipas subjektit, personi i lidhur, bashkëshortja, nuk e ka deklaruar ndonjëherë në deklaratat e pasurisë ndër vite, madje e kishte harruar faktin që ishte akoma emri i saj në llogari. Bashkëlidhur përgjigjeve të datës 15.10.2019, subjekti i rivlerësimit depoziton dhe deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.10.2019, të z. A. L., i cili deklaron ashtu siç pretendohet nga subjekti i rivlerësimit.

25.5. Për këtë llogari bankare të përbashkët të bashkëshortes së subjektit me vëllain e saj, e cila nuk është deklaruar nga personi i lidhur në deklaratën vjetore periodike të vitit 2007 [pas martesës me subjektin e rivlerësimit] dhe as në deklaratën e pasurisë *vetting*, trupi gjykues mban në konsideratë faktin se vlerat e depozituara nga bashkëshortja e subjektit kanë qenë të vogla [90.415 lekë, 40.000 lekë, 20.000 lekë, 10.000 lekë], të justifikuara me të ardhura nga burime të ligjshme, si dhe pretendimet e subjektit për lëvizjet në këtë llogari provohen me të dhënat e dokumentacionit shkresor të administruar në fashikullin gjyqësor.

25.6. Lidhur me mosdeklarimin në deklaratën e pasurisë *vetting* nga personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, të llogarisë së përbashkët bankare me vëllain e saj, Kolegji vlerëson se subjekti i rivlerësimit ndodhet përpara deklaramit të pasaktë, jo në përputhje me nenin 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, por kjo pasaktësi nuk shoqërohet me pamjaftueshmëri të burimeve financiare të ligjshme të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit për shumat e depozituara prej saj në këtë llogari, sipas analizës financiare të kryer në Komision

dhe në Kolegj, e për këtë shkak, për subjektin e rivlerësimit, nuk mund të aplikohet neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

26. Kolegji, bazuar në sa arsyetuar më sipër, vlerëson se subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë si parashikuar nga neni 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit, për kriterin e kontrollit të figurës, është gjetur nga Komisioni i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës dhe i aftë profesionalisht, duke arritur nivel kualifikues në kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, Kolegji çmon se subjekti i rivlerësimit plotëson së bashku kushtet e parashikuara nga neni 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.
27. Në përfundim, Kolegji çmon se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili ka vendosur shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra e gjyqtarit, është marrë në vlerësim jo të duhur të fakteve e provave të administruara prej tij gjatë hetimit administrativ e në zbatim të gabuar të legjislacionit të zbatueshëm, për pasojë ai duhet të ndryshohet.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 220, datë 10.12.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Fatri Islamaj dhe konfirmimin e tij në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Tiranë.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 14.04.2022.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi - kundër

RELATORE

Natasha MULAJ

nënshkrimi - kundër

KRYESUES

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, në cilësinë e relatores së çështjes, kam votuar kundër ndryshimit të vendimit nr. 220, datë 10. 12.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), në ngarkim të subjektit të rivlerësimit Fatri Islamaj, për arsyet si më poshtë.
2. Hetimi administrativ në Komision, për subjektin e rivlerësimit Fatri Islamaj, është kryer për të tria kriteret e rivlerësimit, të vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit profesional, por vendimmarrja për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit Fatri Islamaj nga ana e Komisionit, ka qenë vetëm për kriterin e pasurisë, duke bazuar vendimin në përfundim, në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
 - I. Për kriterin vlerësimit të pasurisë, Komisioni në vendim ka arritur në përfundimet se:
 - *Subjekti i rivlerësimit Fatri Islamaj nuk ka shpjeguar bindshëm lidhur me pasuritë dhe të drejta të tjera reale që subjekti dhe personat e lidhur me të gëzojnë.*
 - *Personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit (bashkëshortja) nuk ka deklaruar në deklaratën “vetting” (dorëzuar më 25.01.2017) një llogari bankare të përbashkët me vëllain e saj, për të cilën Komisioni ka hetuar disa depozita ndër vite, si dhe ligjshmërinë e burimit të krijimit.*
 - *[...] subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi çmon se për apartamentin me sipërfaqe 100 m², ndodhur në rr. “ {***}”, Tiranë, të përdorur prej tij (para dhe pas deklaratës “vetting”), nuk arriti të sigurojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj pasurie.*
 - II. Për kriterin e kontrollit të figurës, [...] subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi. Nuk u provua që subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, të jetë i përfshirë apo i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.
 - III. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, [...] subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe konsiderohet “i aftë”.
Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “c” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
3. Në përmbledhje të sa më sipër, Komisioni, bazuar në pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me vendimin nr. 220, datë 10.12.2019, vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Fatri Islamaj, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë.

I. Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

4. Gjatë shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi, në gjendjen që ishin aktet në fashikullin e përcjellë nga Komisioni, në funksion të vlerësimit për kriterin e pasurisë, në cilësinë e relatores së çështjes, kam qenë dakord të merren në cilësinë e provës, aktet shkresore bashkëlidhur ankimit nga subjekti i rivlerësimit, të cilat do të ndikojnë drejtpërdrejt në zgjidhjen e drejtë të çështjes, sa i përket këtij kriteri, si arsyeja kryesore në konsideratë të Komisionit, për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, ndërkohë që nuk i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për këtë rast, në kundërshtim me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, dhe është shprehur vetëm për formën ligjore të këtyre akteve në vendimin përfundimtar.
5. Duke pasur parasysh qëndrimin tim konstant përgjatë shqyrtimit të çështjeve në Kolegj, lidhur me rastet kur subjekti i rivlerësimit përdor apo posedon një pasuri të personit të lidhur apo tjetër të lidhur, në kuptim të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, ka detyrimin të analizojë dhe evidentojë saktë marrëdhënien juridike që lidh subjektin e rivlerësimit me pasurinë në përdorim, në drejtim të verifikimit të çdo fakti apo rrethane që mund të ngrejë dyshime për fshehjen apo paraqitjen në mënyrë të pasaktë të pasurive në përdorim të tij, që mund të rezultojnë të jenë krijuar nga vetë subjekti i rivlerësimit. Kështu që unë kam qenë dakord me vlerësimin e bërë nga shumica e trupit gjykues, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit.
6. Ndodhur në këtë situatë faktike, ligjore dhe procedurale, në cilësinë e relatores së çështjes, duke vlerësuar se vendimi i Komisionit lidhur me kriterin e pasurisë është i pabazuar, kam qenë kundër vlerësimit të bërë nga shumica e trupit gjykues në paragrafin 26 të vendimit:

[...] Kolegji, bazuar në sa arsyetuar më sipër, vlerëson se subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë si parashikuar nga neni 59, pika 1, shkronja "a" e ligjit nr. 84/2016. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit, për kriterin e kontrollit të figurës, është gjetur nga Komisioni i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës dhe i aftë profesionalisht duke arritur nivel kualifikues në kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, Kolegji çmon se subjekti i rivlerësimit plotëson së bashku kushtet e parashikuara nga neni 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 [...].

– të cilin e gjej të gabuar, pasi kërkesat e ligjit janë të qarta dhe në asnjë rrethanë nuk mund t'i deformosh ato sipas rastit. Në kuadër të këtij procesi, Kushtetuta dhe ligji i kanë dhënë kompetencë të plotë Kolegjit për kontrollin mbi vendimet e Komisionit dhe, në këtë këndvështrim, gjej se në rastin konkret, nuk duhet të ishin marrë të mirëqena konkluzionet e Komisionit për kriterin e kontrollit të figurës, duke marrë shkas nga të dhënat e dokumentacionit të administruar në dosjen gjyqësore, duhej të ishte analizuar dhe marrë në shqyrtim kriteri i kontrollit të figurës për subjektin e rivlerësimit. Çmoj se vlerësimi i shumicës për rastin konkret, është i gabuar, në kundërshtim me dispozitat më sipër.

7. **Për sa arsyetuar, në kushtet kur ligji nr. 84/2016, përkatësisht në nenin 59, pika 1, parashikon se, në rastet e konfirmimit në detyrë të subjekteve të rivlerësimit, duhet të plotëson së bashku këto kushte: subjekti duhet të ketë nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, kur arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, dhe kur arrin një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, pas analizimit të akteve në dosje, vlerësoj:**

II. Lidhur me kriterin e kontrollit të figurës.

8. Ndalem së pari në parashikimin që dispozitat kushtetuese dhe ligjore kanë përcaktuar për këtë kriter, në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, konkretisht:

8.1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin Dh të Aneksit të saj, ka parashikuar se: [...] nëse subjekti i rivlerësimit përpigjet të bëjë deklaratime të pasakta, ose të fshehtë kontaktet me persona të përfshirë në krimin e organizuar, zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.

8.2. Për mënyrën e vlerësimit të këtij kriteri, ligji i posaçëm nr. 84/2016, në neni 35 të tij, përcakton se: subjekti i rivlerësimit plotëson deklaratën për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3 bashkëngjitur këtij ligji, brenda 30 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të tij, dhe e dërgon atë pranë Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar.

9. Në zbatim të këtyre dispozitave, lidhur me plotësimin e deklaratës për kontrollin e figurës, subjekti i rivlerësimit duhej të plotësonte saktë dhe ta dorëzonte brenda afatit ligjor, në përputhje me kërkesat e ligjit.

Nga hetimi administrativ i kryer në Komision, referuar akteve të administruara në dosje, fakteve të provuara lidhur me përgjigjet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit për shkak të kalimit të barrës së provës nga Komisioni, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, parashtrimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit në Kolegj, referuar të dhënave të paraqitura në raportin e paraqitur nga DSIK-ja, çmoj se subjekti i rivlerësimit është përpjekur të bëjë deklaratimin e tij në deklaratën për kontrollin e figurës në mënyrë të pasaktë.

10. Më konkretisht:

- Në raportin nr. {***} prot., datë 01.04.2019³¹, dërguar Komisionit nga DSIK-ja, me lëndë “Dërgohet raporti mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit”, thuhet se: *subjektit të rivlerësimit Fatri Islamaj i është revokuar viza amerikane më datë 26.01.2017. Kjo rrethanë nuk është pasqyruar në deklaratën e kontrollit të figurës, pasi subjekti i rivlerësimit e ka dorëzuar atë më datë 25.01.2017, pra një ditë para revokimit të vizës, arsye që tregon se subjekti i rivlerësimit nuk mund të ishte në dijeni të faktit, por në kompleksitetin e vlerësimit ky revokim duhet të merret në konsideratë.*
- Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, me deklaratën e datës 26.01.2017, në kuadër të procesit të rivlerësimit, ka deklaruar se do të përdorë të gjitha mjetet e duhura ligjore që ka në dispozicion për refuzimin/revokimin e vizave të gjyqtarëve dhe prokurorëve të korruptuar.
- Më datë 26.01.2017, subjektit të rivlerësimit i është revokuar viza turistike e marrë pranë kësaj ambasade në vitin 2015, me afat trevjeçar, deri në vitin 2018. Revokimi i kësaj vize përkon me datën e deklaratës më sipër të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.
- Gjatë hetimit administrativ, pyetjes së Komisionit: *A ju është revokuar viza amerikane në pasaportë, nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës?* - subjekti i rivlerësimit, me përgjigjet e datës 14.02.2019, ka sqaruar se *në fund të janarit ka pasur një telefonatë nga zyra konsullore*

³¹ Raport i deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. {***}, datë 02.04.2019, të KDZH-së.

e Ambasadës së ShBA-së në Tiranë, ku është ftuar të paraqitet pas dy ditësh, pa shpjeguar arsyen e takimit [...].

- Gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, në seancën gjyqësore publike së datës 17.03.2022, i pyetur prej meje, në cilësinë e relatores mbi rrethanat e revokimit të vizës turistike dhe faktit nëse subjekti kishte pasur kontakte të tjera në vazhdim me Ambasadën e ShBA-së, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar të njëjtat argumente si në Komision, që në vlerësimin tim, ishin të pamjaftueshme dhe nuk i përgjigjeshin problematikës së ngritur.
11. Çmoj se arsyet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit se revokimi i vizës amerikane ka ardhur si rezultat i një lapsusi gjatë plotësimit të formularit të aplikimit për vizë emigruese, apo fakti që nuk përmend me saktësi datën kur është kontaktuar nga ambasada për t'u paraqitur, por është shprehur vetëm *në fund të janarit*, apo mosparaqitja e pasaportës dhe mosinteresimi më pas pranë kësaj përfaqësie diplomatike, për t'u informuar konkretisht lidhur me arsyen e takimit të kërkuar nga zyra konsullore, pasi rezulton se është ftuar zyrtarisht nga Ambasada Amerikane, me shkresën e datës 26.01.2017, drejtuar subjektit të rivlerësimit Fatri Islamaj, me anë të së cilës bëhet me dije se duhet të kthejë pasaportën pranë kësaj ambasade për t'u përpunuar. Po kështu, dorëzimi i deklaratës të kontrollit të figurës më datë 25.01.2017 (një ditë më përpara revokimit), duke pasur kohë në dispozicion për depozitim e saj, më shton dyshimin se deklarimi sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, më datë 25.01.2017, është bërë pikërisht për të mos deklaruar faktin e revokimit të kësaj vize, fakt i cili do të ndikonte drejtpërdrejt në procesin e rivlerësimit të tij, në kuptim të kërkesave të ligjit nr. 84/2016, në shtojcën 3, pjesa 5, lidhur me sigurinë, germa “g”, ku thuhet: *Gjatë 10 viteve të fundit, a ju është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s, e për rrjedhojë do të çonte në aplikimin e nenit 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016, pasi subjekti i rivlerësimit në vlerësimin tim ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës.*
12. Në kuadër të këtij procesi, çmoj se revokimi i vizës nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për subjektin e rivlerësimit, kuptohet si standard për pastërtinë e figurës, ku aplikanti i nënshtrohet një procedure të imtësishme dhe të besueshme, dhe revokimi i vizës bëhet për arsye objektive. Në rastin objekt shqyrtimi, në kushtet kur revokimi i vizës përkon me deklaratën e Ambasadës Amerikane për të luftuar me çdo mjet ligjor që ka në dispozicion, për refuzimin/revokimin e vizave të gjyqtarëve dhe prokurorëve të korruptuar, dhe me kohën e hyrjes në fuqi të ligjit të *vetting*-ut, vlerësoj se shumica e trupit gjykues duhet të ishte ndalur në analizimin e këtij fakti dhe jo ta marrë atë të mirëqenë, ashtu siç ka konkluduar Komisioni, kuptohet në kuadër të plotësimit të kushteve të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin e prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”.
13. Për sa kam arsyetuar dhe vlerësuar më sipër, çmoj se vendimi nr. 220, datë 10.12.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit Fatri Islamaj, duhet të lihet në fuqi, por me arsyetim ndryshe, që lidhet me deklaramin e pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës, bazuar në nenin 61/3 të ligjit nr. 84/2016.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtarja Rezarta Schuetz, nuk isha dakord me zgjidhjen e çështjes që i përket subjektit të rivlerësimit Fatri Islamaj dhe votova për lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), që vendosi shkarkimin e tij nga detyra [nr. 220, datë 10.12.2019]. Në vlerësimin tim, subjekti i rivlerësimit nuk arriti nivel të besueshëm në kriterin e kontrollit të pasurisë³² dhe pavarësisht mangësive, vendimi i Komisionit duhej të lihej në fuqi. Më poshtë, në mënyrë të përmbledhur, renditen argumentet e mia.
2. Rezulton që Komisioni ka hetuar për 23 aspekte të pasurisë dhe ka konstatuar probleme për dy prej tyre në konkluzionin përfundimtar, duke gjetur një mungesë burimesh të papërfillshme, ndonëse në përmbajtjen e vendimit – në faqen 25 – ka konstatuar edhe një mungesë burimesh në vlerën 211 mijë lekë për blerjen e një automjeti, e cila nuk gjen asnjë pasqyrim në konkluzionin përfundimtar. Në konkluzionin e Komisionit, ka qëndrim vetëm për dy prej tyre, e konkretisht:
 - (i) Personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit (bashkëshortja) nuk ka deklaruar në deklaratën “vetting” një llogari bankare të përbashkët me vëllanë e saj, për të cilën Komisioni ka konstatuar disa depozita ndër vite, si dhe ka hetuar ligjshmërinë e burimit të krijimit.
 - (ii) Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, meqenëse nuk arriti të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të apartamentit të përdorur prej tij.
3. Sjell në vëmendje që vlerësimet e dërguara nga ILDKPKI-ja dhe DSIK-ja për subjektin, përmbanin vlerësim problematik dhe informacion që përbënte potencialisht indicie problemesh serioze. Konkretisht, sipas aktit të kontrollit për rivlerësimin, ILDKPKI-ja ka konstatuar për këtë subjekt rivlerësimi se “deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin, ka refuzim për deklaram; nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; ka kryer fshehje të pasurisë; ka kryer deklaram të rremë”.
4. Nga ana tjetër, ndonëse DSIK-ja ka përcjellë raport për *përshtatshmëri*, ka rekomanduar që nën dritën e faktit që subjektit i është revokuar viza hyrëse në ShBA në datën 26.01.2017, si pjesë e përpjekjeve të Ambasadës për të përdorur të gjitha mjetet ligjore për të revokuar vizat e gjyqtarëve dhe prokurorëve të korruptuar³³, fakt që subjekti i rivlerësimit nuk e ka raportuar në Deklaratën për Kontrollin e Figurës [shtojca 3] të ligjit nr. 84/2016, Komisioni duhet të vlerësojë këto fakte nën dritën e informacioneve të tjera. Është e paqartë sesi Komisioni e vlerësoi këtë fakt dhe këto konstatime të DSIK-së. Rezulton që në adresë të subjektit kanë mbërritur minimalisht 25 denoncime, disa prej të cilave edhe publike.

³² Sipas përcaktimit detyruës të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016: “[...] 1. Konfirmimi në detyrë i jepet subjektit të rivlerësimit në rast se plotësohen së bashku kushtet e mëposhtme: a) kur arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë [...]”.

³³ <https://al.usembassy.gov/u-s-embassy-statement-9/> – dhe në versionin e përkthyer: <https://al.usembassy.gov/sq/deklarate-e-ambasades-se-shteteve-te-bashkuara-te-amerikes-5/>.

5. Së fundmi, rezulton që Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka gjykuar në [të paktën] tri (3) raste në *kushtet e konfliktit të interesit*. Në një ndër këto raste, çështja është kthyer për rigjykim nga Gjykata e Lartë për shkak të pjesëmarrjes së subjektit në trupin gjykues, në kundërshtim me dispozitat procedurale që garantojnë paanësinë e gjyqësorit dhe procesin e rregullt për palët³⁴. Megjithatë, Komisioni i ka vlerësuar këto çështje pa peshë në rivlerësimin e subjektit, megjithëse në njërën prej tyre subjekti ka qenë në dijeni të konfliktit gjyqësor të vëllait të tij me institucionin shtetëror palë ndërgjyqëse. Sipas Komisionit, meqenëse “palët nuk kanë kërkuar përjashtimin e tij” apo meqenëse subjekti nuk mund të kishte dijeni për marrëdhënien e interesit mes vëllait të tij dhe një personi juridik, gjykimet në kushtet e konfliktit të interesit nuk përbëjnë shkak për shkarkim.
6. Pavarësisht nga sa është përmbledhur më sipër, vendimi i Komisionit për shkarkimin e subjektit, u bazua në thelb vetëm te përdorimi nga subjekti i rivlerësimit i një apartamenti në pronësi të të atit, për një periudhë gjashtëvjeçare. Subjekti pretendoi që ishte marrëdhënie qiraje, Komisioni argumentoi që flitej për marrëdhënie huapërdorjeje dhe, për pasojë, kontrolloi të ardhurat me burime të ligjshme që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie³⁵.
7. Shumica vendosi që pasuria e përdorur nga subjekti nuk e cilëson babanë si huadhënës, pasi përdorimi nuk është huapërdorje dhe vlerësoi se të ardhurat që kanë shërbyer si burim krijimi i këtij apartamenti ishin të dokumentuara dhe plotësonin testin e ligjshmërisë sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Ndonëse isha dakord me shumicën që pasuria në përdorim nga subjekti duhej të hetohej, në zbatim të pikës 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës³⁶, ndava qëndrim të kundërt me të në vlerësimin e burimeve që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie. Në vlerësimin tim, subjekti i rivlerësimit nuk provoi që i ati ka pasur burime të ligjshme për të krijuar këtë pasuri. Ky vlerësim qëndron, pavarësisht nëse marrëdhënia e përdorimit të pasurisë në rrethanat konkrete, shihet si huapërdorje apo në kuadër të përcaktimit të nenit D, pika 1 për përdorimin si parakusht për t’ia nënshtruar pasurinë kontrollit për ligjshmërinë e krijimit.
8. Për sa u përket rrethanave të faktit, të cilat përbënë në thelb shqyrtimin e kryer nga Kolegji, rezulton që subjekti i rivlerësimit ka përdorur për përreth 6 vite një apartament me sipërfaqe 100 m², ndodhur në rr. “{***}”, Tiranë, që është porositur dhe mobiluar prej të atit. Subjekti pretendoi se ka qëndruar në këtë apartament kundrejt qirasë prej 15 mijë lekësh. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti ka përcjellë një deklaratë noteriale të hartuar nga i ati në shtator 2016 – pesë vite pasi pretendohet të jetë vendosur kjo marrëdhënie juridike dhe pasi ishte miratuar ligji nr. 84/2026 – për të konfirmuar qiranë.
9. Ashtu si shumica, isha e mendimit që në rrethanat konkrete, pretendimi për marrëdhënien e qirasë nuk ishte bindës. Së pari, sepse subjekti nuk e ka deklaruar asnjëherë këtë marrëdhënie në deklaratat periodike – që duke përbërë provë në procesin e rivlerësimit [neni 32, pika 5 e

³⁴ *Vendimi i Gjykatës së Lartë nr. 307, datë 12.04.2017. Referuar në faqen 38 të vendimit objekt shqyrtimi të Komisionit.*

³⁵ *Konkluzioni mbi mungesën e deklarimit nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë të llogarisë dyemërore, është parë në drejtim të analizës financiare duke iu atribuar personit të lidhur gjysma e gjendjes në fund të çdo viti.*

³⁶ *“1. Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklarimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur [...]”.*

ligjit nr. 84/2016] – do të krijonin besueshmëri për ekzistencën e kësaj gjendjeje. Së dyti, sepse deklarata noteriale e babait të subjektit të rivlerësimit, e kryer në fund të shtatorit 2016, të paktën pesë vite pasi kishte nisur kjo marrëdhënie qiraje, pak muaj pasi ishte miratuar ligji nr. 84/2016 dhe pak muaj përpara hartimit të deklaratës së pasurisë *vetting*, ka gjithë pamjen e një veprimi të kryer për efekt të rivlerësimit. Sjell në vëmendje se edhe kontrata e qirasë e pretenduar, pavarësisht se është lidhur për pesë vite, në fakt ka përfunduar në nëntor të vitit 2017, pak më shumë se një vit pasi është krijuar.

10. Ndaj qëndrim të ndryshëm me shumicën për sa i përket çështjes së provueshmërisë së burimeve të ligjshme që kanë shërbyer për krijimin e këtij apartamenti. Nga aktet, rezulton që apartamenti është porositur nga babai i subjektit të rivlerësimit në datën 23.09.2010, për 65 mijë euro. Prej kësaj vlere, 50 mijë euro janë paguar ditën e nënshkrimit të kontratës. Subjekti i rivlerësimit në vitin 2014, ka deklaruar në ILDKPKI se burim krijimi i pasurisë kanë qenë të ardhurat e dy vëllezërve dhe motrës së tij [3 kontribuues]. I ati i subjektit të rivlerësimit, në një deklaratë noteriale të hartuar gjatë hetimit administrativ në vitin 2019, ka pretenduar se apartamenti është blerë me kontributet financiare të katër (4) prej fëmijëve të tij – tre vëllezërve të subjektit dhe të motrës. I vetmi që nuk deklarohet të ketë kontribuar, ishte subjekti i rivlerësimit. Është fakt i padiskutueshëm dhe i pakontestuar nga subjekti dhe i ati që asnjë nga kontribuuesit në blerjen e këtij apartamenti – vëllezërit dhe motra e subjektit – nuk kanë përdorur apo gëzuar ndonjëherë frytet e kësaj pasurie, nëpërmjet përdorimit apo të ardhurave nga qiradhënia. I vetmi që ka përdorur këtë apartament dhe, për rrjedhojë, ka gëzuar frytet e punës së vëllezërve dhe motrës emigrantë, ka qenë subjekti, magjistrat, dhe personi i lidhur, me profesion mjeke.
11. Për një kontekst të plotë të rrethanave faktike, sjell në vëmendje që babai i subjektit të rivlerësimit rezulton të ketë blerë edhe një apartament tjetër, në vitin 2007, në vlerën 56.700 euro. Edhe për atë apartament, janë deklaruar si burime të ardhurat nga emigracioni i fëmijëve – A., A., F. dhe F. I..
12. Përpos këtyre dy apartamenteve, babai i subjektit, pensionist prej vitit 1998, ka në pronësi dhe ka pasur të regjistruara një sërë aktivitetesh private, të gjitha pasi subjekti është emëruar gjyqtar. Në disa prej aktiviteteve, rezulton që babai i subjektit ka lëvizur shuma të konsiderueshme monetare, në formë depozitash apo marrje huash. Komisioni nuk ka kryer asnjë hetim edhe për këto veprimtari, në funksion të përjashtimit të mundësisë që fondet e konsiderueshme të lëvruara, të ishin në fakt të vetë subjektit. Nga akti i kontrollit të kryer nga ILDKPKI-ja³⁷ për subjektin e rivlerësimit, në funksion të procesit të rivlerësimit, rezulton që babai i subjektit të rivlerësimit [z. B. I.]: (i) ka filluar aktivitetin privat në vitin 2006, në moshën 65-vjeçare dhe ka vijuar duke (ii) krijuar e marrë përsipër 100% të aksioneve në katër (4)

³⁷ Sipas aktit të kontrollit në funksion të procesit të rivlerësimit, më datë 05.03.2018, ndër të tjera konstatohet se babai i subjektit të rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për blerjen e dy njëzive tregtare [njëra prej të cilave apartamenti ku banonte subjekti deri në vitin 2017], për një apartament në {***} (Tiranë) në vlerën 35 mijë euro, një njësi me sipërfaqe 108 + 128 m² për shumën 12 milionë lekë, mungesë burimesh për blerjen e një apartamenti pranë {***}, mungesë burimesh për derdhjet në llogari në depozitë në BKT në vlerën 24,7 milionë lekë në harkun kohor korrik 2013 – shtator 2014, të paqarta transaksionet që lidhen me tërheqjen e shumës prej afro **16 milionë lekësh** në harkun kohor qershor—shtator 2014, huamarrjet nga persona të ndryshëm në vlerën prej mbi **90 milionë lekësh**, për të cilat nuk dihet destinacioni, transaksione të dyshimta për një apartament prej 96 m² në {***}, blerë nga djali A. I. për 45 mijë euro në gusht 2014, dhuruar babait B. I. 1,5 muaj më vonë, shkëmbyer nga ky i fundit me tokë arë me sipërfaqe 6300 m² në {***}, Durrës, në vitin 2015.

aktivitete biznesi³⁸. (iii) Tri ndër aktivitetet kanë qenë pronë e tij për periudha kohore nga tetë (8) deri në nëntë (9) muaj, nga viti 2010 deri në vitin 2013. (iv) Asnjë prej aktiviteteve nuk ka deklaruar fitime. (v) Tri prej tyre janë shitur në vitin 2013. (vi) Ka marrë hua nga individë të ndryshëm në vlerën totale prej mbi 90 milionë lekësh [662 mijë euro] më 03.12.2012. Ndërkohë, babai i subjektit të rivlerësimit ka në pronësi pesë (5) pasuri të paluajtshme, nga të cilat tri në Tiranë, një truall dhe ndërtesë në Tropojë dhe një pasuri në Vlorë, një tokë në bregdet ({***}, Durrës).

13. Duke iu kthyer pasurisë së përdorur nga subjekti i rivlerësimit për gjashtë (6) vite, vlerësova se burimet e ligjshme të krijimit të saj duhet të ishin analizuar duke përfshirë të gjitha rrethanat kontrolluese, përfshirë edhe ato të konstatuara më sipër. Në pikën fundore, pyetja që do të duhet të ishte ngritur, ishte nëse rrethanat e konfirmuara tregonin se subjekti i rivlerësimit kishte në përdorim një pasuri e cila ishte krijuar në mungesë të burimeve të ligjshme – që nënkupton që nuk kalon testin e vendosur nga neni D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës. Nëse po, dhe në kushtet kur vendimi i Komisionit në thelb nuk e përjashton dyshimin për pasuri të fshehur, në analizën për mundësinë e krijimit të pasurisë me burime të ligjshme, trupi gjykues do të duhej të shihte me kujdes çdo indicie dhe çdo dokumentacion, duke marrë vendim mbi këto akte dhe për të përjashtuar pretendimet e mbetura në nivel deklarativ dhe për prezantim të fakteve në një formë që përkul faktet në favor të pasqyrit artificial të ndodhive, sipas kërkesave të subjektit të rivlerësimit.
14. Ndaj të njëjtin qëndrim me *Opinionin*³⁹ e vëzhguesit ndërkombëtar të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, paraqitur në Kolegj. Ndër të tjera, *Opinionin* shprehet që Komisioni në vendim, nuk ka përjashtuar plotësisht mundësinë që subjekti i rivlerësimit të jetë realisht pronari përfitues i kësaj pasurie. Në vlerësimin tim, për pasuritë në përdorim, për të cilat mungojnë provat e burimeve të ligjshme të blerjes, ndërkohë që mungon edhe një përfundim lidhur me fshehjen e pasurive, nën dritën e faktit që neni D, pika 1⁴⁰ e Aneksit të Kushtetutës u ka atribuar subjekteve të rivlerësimit detyrime për përdorimin, të barabarta me pronësinë, Kolegji do duhet të kryejë një vlerësim objektiv dhe harmonik të rrethanave specifike të rastit. Ky vlerësim do të duhet të marrë në konsideratë kohën e përdorimit dhe rrethana të tjera specifike, peshën ekonomike të përdorimit të pasurisë dhe impaktin të vlerësimi i përgjithshëm i subjektit të rivlerësimit. Një vlerësim i kujdesshëm, analitik dhe në harmoni me faktet në rrethanat konkrete, do të duhet të shqyrtonte elemente, si: cilësia dhe çmimi i pasurisë/sendit në përdorim, ekskluziviteti i përdorimit, kohëzgjatja e përdorimit⁴¹.
15. Për sa më sipër, proporcionaliteti dhe objektiviteti si parime, në rrethanat konkrete të këtij subjekti rivlerësimi, duhet të ishin përkthyer në qasje analitike të thelluar nga Kolegji, në mënyrë që faktet të qartësohen dhe atyre t'u jepet një vlerësim objektiv: nëse asnjë alternativë

³⁸ Një ndër to [{***}] e ka marrë nëpërmjet kalimit të 100% të kapitalit nga djali, z. F. I..

³⁹ Administruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 23.03.2022.

⁴⁰ Neni D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës përcakton: “1. Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklarimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur [...]”.

⁴¹ Paragrafi nr. 5, faqja 4 e “Opinionit” të vëzhguesit ndërkombëtar.

nuk përputhet me analizën logjike të fakteve, deduksioni i arsyeshëm për fshehje të pasurisë do duhet të pranohet.

16. Shumica nuk ndoqi hapat e mësipërm, duke u bazuar në pretendimet deklarative të subjektit, veprim që ndër të tjera bie ndesh me detyrimin që përcakton neni 49, pika 4⁴² e ligjit nr. 84/2016 për të vendosur mbi bazën e dokumenteve nga burime të njohura, në prova të besueshme ose në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Subjekti i rivlerësimit, gjatë procesit në Kolegj, ka paraqitur dokumentacion për të ardhurat e vëllait të tij në Zvicër për disa vite. Votova kundër pranimit të tyre në parim, për shkak të kohës së vonuar kur subjekti zgjodhi t'i sjellë. Së dyti, nga faqja zyrtare në internet e institucionit që konfirmon këto të ardhura, njoftohet në tri gjuhë që këto shifra përbëjnë të ardhurat bruto, jo neto⁴³. Së treti, dhe ajo që është më e rëndësishmja, vlerësoj që edhe sikur të pranoheshin të mirëqena këto të ardhura, nuk ka asnjë gjurmë dokumentare apo edhe rrethanore se sa prej këtyre të ardhurave janë dërguar nga vëllai i subjektit të atit, në çfarë vlerash, në cilat vite dhe përse.
17. Më konkretisht, pretendohet për dërgim nga Zvicra të një shume prej 65 mijë eurosh deri në shtator 2010, përpos një kontributi prej 56.700 eurosh deri në vitin 2007. Në total, flitet për një shumë prej përreth 115 mijë eurosh të dërguara *cash* në Shqipëri nga z. F. I., në periudhën kohore 2002-2007, e cila nuk ka lënë asnjë gjurmë dokumentare, qoftë në Zvicër apo në Shqipëri. Duke abstraguuar nga fakti që pagesa e rrogës apo shpërblime e transaksione të tjera nëpërmjet *cash*-it, në vende me sistem bankar të avancuar janë përjashtim nga rregulli, sjell në vëmendje që në terma praktikë, pretendimi i ngritur nga subjekti dhe pranuar nga shumica nënkupton që në tërheqjen e shumave të konsiderueshme për të financuar blerjen e apartamenteve në Tiranë, z. F. I. logjikisht do të duhet të kishte lënë gjurmë tërheqjesh në bankë, në çfarëdo vlere. Subjekti i rivlerësimit nuk sollti asnjë dokument qoftë edhe rrethanor që të provonte tërheqje të çfarëdo vlere në periudhat kohore përpara blerjes së apartamentit.
18. Është po ashtu përtej logjikës që dikton një analizë e ftohtë faktesh përse shumat e gjendura në llogari bankare, tërhiqen në *cash* dhe nisen në forma rastësore drejt një vendi tjetër, ndërkohë që qëllimi mund të përmbushej brenda pak minutash, me sigurinë maksimale në transfertë dhe në pritje nëpërmjet bankës, me thjeshtësinë dhe efikasitetin që vetëm institucionet financiare mund të sigurojnë. Asnjë hyrje nuk rezulton të ketë ndodhur në drejtim të z. B. I. nga Zvicra, përkundrazi. I vetmi transaksion bankar i provuar me akte, ka kah të kundërt, e konkretisht: subjekti i rivlerësimit i ka dërguar vëllait F. I. në Zvicër, nëpërmjet bankës, 2650 euro në datën 10.10.2005⁴⁴.
19. Shumica i pranoi këto pretendime evazive dhe deklarative të subjektit që në pikën fundore sjellin si pasojë, në terma praktikë, që: për sa kohë pretendohet investim në një pasuri të përdorur nga një subjekt rivlerësimi, burimi i ligjshëm e kalon testin e kërkuar nga ligji, mjafton që në fotografinë e pretendimeve të subjektit, të rezultojë se dikur dhe diku një individ i identifikuar të ketë pasur burime financiare të mjaftueshme, ndonëse nuk provohet mënyra se

⁴² “[4]. Komisioni dhe Kolegji i Apelit i bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes [...]”.

⁴³ <https://svazurich.ch/unsere-produkte/ahv/beitraege/beitragspflicht/angestellte.html>.

⁴⁴ Referuar në faqen 22 të vendimit të Komisionit.

si ato mjete monetare janë vënë në dispozicion të krijimit të pasurisë, ashtu siç nuk provohen arsyet përse kontribuuesi – në këtë rast, vëllai emigrant i subjektit – zgjidhte të kanalizonte gjithë të ardhurat e tij – qoftë edhe sikur të pranohet e mirëqenë vlera neto – në shërbim të jetesës më të mirë të vëllait dhe bashkëshortes, të dy të punësuar dhe me rroga relativisht të larta për standardet e vendit.

20. Këto pretendime të subjektit të pranuar pa analizë kritike, bien ndesh edhe me rrethana të tjera faktike. Ndërsa në ILDKPKI subjekti ka pretenduar në vitin 2014, se kontributet ishin nga dy prej vëllezërve [dhe motra], i ati i subjektit, nëpërmjet një deklarate noteriale, të kryer gjatë hetimit administrativ [në vitin 2019], ka shtuar edhe një kontribuues tjetër, djalin A. I. Rezulton se ky i fundit ka qenë punonjës buxhetor me pagë më të ulët se edhe vetëm vetë subjekti, dhe vetëm duke filluar nga viti 2008. Në kohën kur është blerë apartamenti ku jetonte subjekti – dhe për të cilin pretendohet të ketë kontribuar edhe z. F. I. – ai kishte punuar për përreth tri vite dhe paguhej me një rrogë modeste. Në vitet pararendëse, vëllai në fjalë ka pasur shpenzime studimesh në Britaninë e Madhe. Mbulimi i shpenzimeve të jetesës në Britaninë e Madhe nga e motra, po ashtu, mbeti në nivel deklarativ. Nga një kërkim në burime të hapura, vetëm shpenzimet e shkollimit në universitet rezultojnë përreth 25 mijë dollarë amerikanë⁴⁵.
21. Në rrethanat konkrete, babai i subjektit të rivlerësimit rezultoi në pamundësi për të krijuar me burime të ligjshme, ndër të tjera, dy apartamentet e analizuara nga Komisioni. Të ardhurat e pretenduara nga emigracioni nga z. F. I., në analizën e kryer në Kolegj, jo vetëm nuk u dokumentuan në vlerën e tyre neto, por dërgimi i tyre nuk u provua në asnjë formë, përpos që nuk ka asnjë qartësi për mënyrën se si janë dërguar. U kërkua dhe u pranua një skenar i paqartë dhe alogjik faktesh, ndonëse me peshë vendimtare në fazën e procesit në Kolegj për rivlerësimin e subjektit.
22. Për sa më sipër, votova kundër shumicës për sa i përket zgjidhjes përfundimtare të çështjes dhe mënyrës së arsyetimit. Në vlerësimin tim, trupi gjykues do të duhet t'i kishte cilësuar rrethanat e faktit saktë dhe në mënyrë autonome dhe të kishte zbatuar pasojën juridike të shkarkimit. Subjekti i rivlerësimit rezultoi se nuk arriti në nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, një kusht i domosdoshëm për konfirmimin në detyrë.
23. Edhe në analizë të shkaqeve të reduktuara të shkarkimit, të cilat ishin ende objekt kontrolli, si pasojë e vendimmarrjes së pabazuar në fakte dhe në ligj të Komisionit, shtjelluar më sipër në detaj, subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion burimet e ligjshme të krijimit të pasurisë që ai ka pasur në përdorim për gjashtë vite. Në këto kushte, subjekti gjendej në pamundësi për të kaluar testin e vendosur nga neni D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës. Të gjitha këto rrethana nuk u vlerësuan saktë nga shumica, e cila pranoi pretendime deklarative për të ardhura, shuma ekzakte e të cilave nuk u provua, ashtu siç nuk u provuan as dërgimet e tyre në Shqipëri. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë.

GJYQTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

⁴⁵ Për detaje të shkollimit të z. F. I., sipas shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, shih faqen 17 të vendimit të Komisionit.